

## Rendi i ditës

### Qendra Rinore Fisnikët,

anëtare e Koalicionit për KOMRA, organizon:

### Konsultimet lokale me shoqërinë civile nga rajoni i Prizrenit, mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-s

24.02.2010

Hotel Theranda, Prizren

- |               |  |
|---------------|--|
| 10:00 -10:05  | <b>Hapja e takimit dhe prezantimi i gjithë pjesëmarrësve</b><br><b>Isuf Halimi, Fisnikët</b>   |
| 10:05 -10:15  | <b>Përse KOMRA?</b><br><b>Besarta Vasija, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë</b>  |
| 10:15 – 10:30 | <b>Informimi i pjesëmarrësve me rrjedhën e procesit konsultativ në vendet e ish Jugosllavisë dhe krahasimi me përvojat e të tjerëve në verifikimin e fakteve për të kaluarën:</b><br><br><b>a) Qëllimet e procesit konsultativ</b><br><b>b) Mendimet e thëna, propozimet dhe rekomandimet mbi elementet dhe aktivitetet e KOMRA-s:</b><br>Faktet dhe shkaqet e luftës<br>Mandati i komisionit për të vërtetën<br>Qëndrimi ndaj gjykatave për krime lufte<br>Regjistrimi i viktimave dhe humbjeve në njerëz<br>Kriteret për zgjedhjen dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit<br>Struktura e komisionit<br>Dëgjimi publik i viktimave<br>Qëndrimi ndaj kryerësve të krimeve<br>Pajtimi |
|               | <b>Nora Ahmetaj, anëtare e Koalicionit për KOMRA</b>   |
| 10:30 – 10:45 | <b>Film dokumentar “Komisioni i Perusë”</b>  |
| 10:45 – 12:00 | <b>Çfarë KOMRA?</b><br>Diskutim mbi mandatin e KOMRA-s<br>Besarta Vasija, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë  |
| 12:00 – 13:00 | Pauza për drekë  |
| 13:00 – 15:50 | <b>Vazhdim i diskutimit</b>  |
| 15:00 – 16:00 | <b>Fjalët përmbyllëse</b>  |

Unë quhem **Isuf Halimi**, jam udhëheqës i Qendrës Rinore Fisnikët në Prizren, ku si qendër rinore veprojmë afër dhjetë vite, kryesisht në ndërtimin e paqes dhe tolerancës. Për ne, si qendër rinore dhe grup rinor është interesant të jemi pjesë e këtij koalicioni KOMRA që i ka disa tema interesante dhe qëllimi është interesant për të inkuadruarit, dhe sot diskutohet për herët e parë një temë e rëndësishme në regjionin e Prizrenit. Kisha për ta prezantuar Besartën, e cila është paneliste sot dhe Nora, bashkë që është këtu me ne. Para se ta bëjmë prezantimin e të gjithë pjesëmarrësve, për arsye se bëhet incizimi dhe dokumentimi i konferencës, kisha me bë edhe prezantimin e rendit të ditës, apo agjendës ku në sesionin e parë do të flasim: Përse KOMRA duhet të jetë, për të cilën do të na flasë Besarta Vasija, prej Fondit për të drejtën humanitare në Kosovë.

Sesioni i dytë përfshin rrjedhën e procesit të konsultimeve në Kosovë dhe regjion, pastaj kemi filmin dokumentar i cili do të shfaqet. Dhe, pas pauzës për drekë, do të rikthehemi në diskutime. Atëherë, kisha dashur me rend të fillojmë prezantimin. Do të fillojmë prej anës së djathtë ose “leidis first”. Ju lutem, të prezantohen pjesëmarrësit me emrin, mbiemrin, institucionin prej nga vinë dhe vendin.

Faleminderit, shumë! Unë jam **Besarta Vasija**, punoj për Fondin për të Drejtën Humanitare. Jam koordinatore në Koalicionin për themelimin e KOMRA-s dhe në procesin konsultativ në Kosovë.

Unë jam **Nora Ahmetaj**, aktiviste për të drejta të njeriut në Kosovë dhe anëtare e Koalicionit për KOMRA-n, Prishtinë.

**Avni Melenica**, Shoqata për persona të zhdukur 22 Maji në Vushtrri/Vuçitrn, anëtar i Koalicionit për KOMRA-n.

**Raif Kirkul**, Gazeta turke kosovare, Prizren.

**Hajrullah Skurtak**, Kryetar i Teatrit Turk – Prizren.

**Ethem Bajmak**, Shoqata e artistëve turk të Kosovës, Prizren.

**Mentor Llapatinca**, sekretar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës, Prizren.

**Bujar Ukimeraj**, anëtar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës, si dhe veteran i luftës, Prizren.

Quhem **Azem Pula**, anëtar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës, Prizren.

**Ferhat Dervish**, Filizler, Prizren.

Jam **Ejup Kabashi**, kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës, dega në Rahovec/Orahovac.

Jam **Nazmi Bellaça**, nënkryetar i Shoqatës së Invalidëve, dega në Rahovec/Orahovac.

Jam **Avdyll Morina**, sekretar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, dega Malishevë/Mališevo.

Jam **Sahit Thaçi**, nënkryetar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës, Malishevë/Mališevo.

**Halil Berisha**, nënkryetar i veteranëve të luftës, Malishevë/Mališevo.

**Refki Morina**, sekretar i Organizatës së veteranëve të UÇK-ës, Malishevë/Mališevo.

**Bashkim Gashi**, KMLDNJ (Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut), Prizren.

**Vera Krasniqi**, nga Shoqata e të verbërve, Prizren.

**Miradije Buçaj**, koordinatore e Shoqatës të verbërve, Prizren.

**Fatime Haliti**, jam nga Shoqata “Durmish Asllana” Prizren.

**Samir Mujo**, nevladina organizacija “Relaks” Prizren.

**Delvir Dejri**, organizata jo-qeveritare “Ling”, Prizren.

**Birsen Gota**: “Zybezda hanim”, shoqata e grave turke, Prizren.

**Jaser Ymeri**, kryetar i rinisë së fshatit Bllacë/Blaçe.

**Haki Semahodaj**, anëtar i Kryesisë së Shoqatës së familjeve të dëshmorëve, dega në Prizren.

**Nazli Tyfekçiu**, menaxhere e Qendrës Hendikos, Prizren.

**Semra Dana**, Hendikos, Prizren.

**Ymer Krasniqi**, Shoqata e Veteranëve të Luftës, Prizren.

**Hysen Destani**, anëtar i Kryesisë së Shoqatës së Organizatës së veteranëve të luftës, Prizren.

**Abaz Bobaj**, anëtar i Kryesisë së shoqatës së veteranëve, Prizren.

**Murat Rexhepi**, Shoqata e familjeve të dëshmorëve, anëtar i familjes së dëshmorëve, Prizren.

**Hamit Ademaj**, kryetar i Shoqatës së familjeve të dëshmorëve të UÇK, dega në Prizren.

**Hasan Ilijazi**, Asociacioni i ideve bashkëkohore, Prizren.

**Xhelil Toro**, Krushevë/Kruševo.

**Admir Idrizi**, Organizata rinore, Krushevë/Kruševo.

**Behar Brenoli**, Organizata rinore, Krushevë/Kruševo.

Përhëndetje të gjithëve. Jam **Haqif Ilazi**, nga Shoqata e të burgosurve politik, Prizren.

**Bylbyl Duraku**, kryetar i Shoqatës së burgosurve politikë, Prizren.

Faleminderit! Unë jam **Nazim Bahtiri**, anëtar i Organizatës joqeveritare “Youth step”, Vushtrri/Vučitrn. Është kënaqësi, të jam sot në mesin tuaj. Suksese!

**Avni Ademi**, nga “Youth Step”, Vushtrri/Vučitrn.

**Shehida Miftari**, OSCE, Prizren,

**Valerija Vukman**, OSCE, Prizren.

**Nuhija Tahirovci**, drejtor i Kuvendit Komunal, Dragash/Dragaš.

**John Merdsen**, ICO, Prizren.

**Fisnik Dida**, ICO, Prizren.

Major **Tomas Hohl**, KFOR-i Gjerman, Prizren.

**Valentina Morreta**, IPSIA italian NDO, Prizren.

**Rino Mejer**: Rino Mejer, Caritas, Luksemburg.

**Rifat Krasniqi**: Rifat Krasniqi, Caritas-i Luksemburgut.

**Vildane Vinci**, Caritasi zviceran, Prizren.

**Alisa Virdaini**, Caritasi zviceran, Prizren.

**Indira Elshani**, Caritasi zviceran, Prizren.

**Isuf Halimi:** OK. Faleminderit shumë! Para se t'ia jap fjalën Besartës, kisha kërkuar një falje nga komuniteti turk dhe rom, për arsye të mjeteve të kufizuara të projektit s'kemi mundur të sigurojmë përkthimin në gjuhën e tyre. Njëkohësisht më duhet të them se sot kemi përkthim vetëm në gjuhën shqipe dhe gjuhën boshnjake dhe për ata që janë të interesuar të dëgjojnë mund t'i dëgjojnë përkthyesit. Besarta!

**Besarta Vasija:** Faleminderit, Isuf! Unë së pari desha të ju falënderoj të gjithëve që keni gjetur kohë të vini në këto konsultime. Për mua është nder i veçantë që në rajonin e Prizrenit kemi kaq shumë pjesëmarrës prej shoqërisë civile.

Pra, siç dihet, për këtë temë sot, kjo është herë e parë që në regjionin e Prizrenit do të flasim për iniciativën për themelimin e KOMRA-s. Unë së pari do të flas përse është iniciativa KOMRA dhe çka është iniciativa KOMRA.

Pra, duke ditur se kanë kaluar afër 11 vite nga mbarimi i luftës në Kosovë dhe 16 vite e më shumë të luftës në Slloveni, Kroaci, në Bosnje e në vende të tjera, kemi parë se deri sot nuk është arritur të kthehet ende dinjteti i viktimave dhe nuk është arritur të ketë drejtësi për viktimat.

Pra, siç e dimë, Gjykata për krime të luftës në Hagë dhe gjykatat vendore në vendet e ish-Jugosllavisë për krime të luftës, edhe pse kanë procesuar shumë raste për krime të luftës, megjithatë nuk është numër i mjaftueshëm në krahasim me numrin e kriminelëve që kanë bërë krime në gjitha vendet e ish-Jugosllavisë.

Pra, vetëm në Kosovë, qysh nga viti 2001 e deri në vitin 2010 janë procesuar vetëm 20 raste për krime të luftës, ku 10 prej tyre kanë përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm, 2 janë diskutabile, ndërsa tjerat janë ende të hapura. Prandaj, për këto dhjetë vite 20 raste janë shumë pak dhe fatkeqësisht me këto pak raste nuk mund të arrijmë t'i verifikojmë krimet e luftës dhe assesi nuk mund të arrijmë të kemi drejtësi për viktimat.

Tri organizata joqeveritare, Fondi për të Drejtën Humanitare nga Serbia, Dokumenta nga Kroacia dhe Qendra Hulumtuese-Dokumentuese nga Bosnja e Hercegovina, në vitin 2006 kanë filluar debatin publik lidhur me atë se cilët janë mekanizmat tjerë jashtëgjyqësor që do të na ndihmonin për të arritur deri te faktet rreth krimeve të luftës.

Gjatë këtij debati publik është arritur një marrëveshje që, përveç gjykatave të cilat janë instrumente gjyqësore për verifikimin e fakteve dhe për dënimin e kriminelëve të luftës, duhet të ekzistojë apo të themelohet edhe një komision rajonal i cili do të merret me përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në vendet e ish-Jugosllavisë.

Prandaj, në tetor të vitit 2008, në Prishtinë, është themeluar Koalicioni i organizatave joqeveritare, shoqatave të viktimave, individëve të cilët e mbështesin këtë iniciativë. Ky koalicion e ka për qëllim marrjen e mbështetjes prej të gjitha shoqërive nga vendet e ish-Jugosllavisë dhe gjatë procesit konsultativ marrja e mendimeve, ideve dhe të rekomandimeve të pjesëmarrësve se si duhet të duket mandati i komisionit rajonal.

Qëllimi tjetër është që kjo iniciativë, pra kjo kërkesë e jona të pranohet nga qeveritë meqenëse ne e dimë që komisionet janë trupa zyrtarë dhe këto nuk mund t'i themelojë shoqëria civile. Ato duhet të formohen nga vetë qeveritë respektive. Prandaj, shoqëria civile për obligim e kanë marrë shtytjen e këtij procesi, krijimin e mandatit që do ta formojmë gjatë procesit konsultativë, dhe mbledhjen e 1 milionë nënshkrimeve të atyre që e mbështesin këtë iniciativë, pastaj këto t'i dorëzojmë te qeveritë apo shtetet që kanë dalë nga ish-Jugosllavia.

Çka është me rëndësi? Pse është kjo qasje rajonale, pse duhet të jetë një komision rajonal?

Ne e dimë se kanë ekzistuar disa tentime për themelimin e komisioneve të cilat janë komisione shtetërore siç ka qenë në Bosnje e Hercegovinë dhe në Serbi, p.sh edhe Koshtunica atëherë e ka iniciuar themelimin e një komisioni nacional, dhe përveç komisionit të Srebrenicës e cila e ka bërë regjistrimin e të gjitha viktimave në Srebrenicë tjerat kanë qenë të dështuara. Arsyeja pse kanë dështuar, është se ato kanë qenë në nivelin nacional, prandaj ne e dimë se këto luftëra nuk kanë qenë në nivelin nacional por kanë qenë në nivelin rajonal. Komisionet nacionale nuk mund të arrijnë të kenë qasje në dokumente të cilat nuk janë vetëm në një shtet e po ashtu edhe për kriminelët të cilët gjenden në shtete të ndryshme. Ne e dimë se kemi, për shembull, grupe të ndryshme të cilat kanë luftuar në Bosnje e Hercegovinë dhe kanë bërë krime, sikur që është rasti i grupit të “shkorpionëve” që kanë bërë krime në Srebrenicë, i njëjti grup ka bërë krime edhe në Podujevë, pra në Kosovë. Prandaj, ne assesi nuk mund të kemi një komision të suksesshëm nëse ne nuk kemi qasje te kriminelët dhe nëse nuk mund të kemi qasje në arkivë e cila nuk gjendet ketë, po në Serbi.

Për këtë arsye, ne na duhet një komision rajonal ku do të kemi qasje nëpër arkivat në Serbi, apo në vende të ndryshme për kriminelët që jetojnë në vende të ndryshme e kanë bërë krime jo në vendin e tyre por në vende tjera, e po ashtu edhe për gjetjen e varrezave apo për zbulimin e varrezave masive, e që ne e dimë se dyshohet që ka ende varreza masive si në Serbi e po ashtu edhe në Bosnje e Hercegovinë dhe po ashtu ka dyshime se ka edhe në Maqedoni. Prandaj, kjo është ajo që arsyeton këtë iniciativën tonë që ne kërkojmë të jetë në rajonale.

Ne e dimë se ekziston një mosbashkëpunim apo një mosgatishmëri e shteteve për të krijuar një komision të tillë dhe e dimë se do të jetë shumë e vështirë dhe do të jetë herë e parë në botë që kërkohet të themelohet një komision në nivelin rajonal. Prandaj, ne si shoqëri civile, që e kemi obligim që ta shtyjme këtë iniciativë për të ecë përpara, dhe me mbledhjen e 1 milionë nënshkrimeve prej të gjithë shoqërisë ne e legjitimojmë kërkesën tonë dhe me këtë i bëjmë presion parlamenteve të shteteve tjera që këta ta pranojnë këtë iniciativë. Pra, ne kemi qëllim që të mos formohet diçka nga lartë dhe kjo t’i servohet shoqërisë, do të thotë, si diçka e gatshme, siç ka ndodhur deri sot me shumë iniciativa të ndryshme dhe ne kemi pasur dëshirë që të fillohet nga themeli, nga vetë viktimat, nga vetë shoqëria për të ditur se cilat janë nevojat e tyre, cilat janë problemet e tyre, sepse shoqëria nganjëherë as nuk pyetet fare për këto, të themi, prej qeverive apo njerëzve të cilët marrin vendime. Prandaj, ne kemi pasur për obligim të fillojmë nga shoqëria civile, nga viktimat, t’i pyesim ata çka mendojnë, cilat krime duhet të hulumtohen nga KOMRA, çka mendojnë dhe kush duhet të jenë komisionarë, si duhet të zgjedhën ata e shumë çështje të tjera për të cilat do të flasim më vonë.

Ky komision do të thotë nuk do të jetë assesi që t’i zëvendësojë gjykatat. Ky komision do t’i ndihmojë gjykatat me fakte, prandaj ky komision ka me qenë edhe plotësisht i pavarur prej themeluesve të saj, ka me qenë e pavarur prej vetë qeverive, të parlamentit apo presidentit e kushdo që e themelon.

Ky komision do të jep hapësirë, pra do të krijojë një platformë për viktimat, ku viktimat do të mund të flasin, t’i tregojnë përjetimet e veta, viktimat do të tregojnë atë çka ka ndodhur vërtetë me ta.

Pastaj, ky komision do të mund t'i ndihmojë prokurorive për mbledhjen e provave për krimet e luftës dhe mund tu ndihmojë komisioneve ekzistuese për të zhdukurit dhe për të zgjidhur fatin e të zhdukurve dhe rastet ose edhe gjetjen e varrezave tjera masive, të cilat ekzistojnë dhe ende nuk janë të zbuluara.

Pra, KOMRA duhet të jetë rigorozisht e ndarë dhe e pavarur prej themeluesve të saj. Kjo do të jetë një trup i cili do të fokusohet në vetë përvojat e viktimave dhe qëllimi ynë është që viktima do të jetë në fokus, do të thotë vetë viktima.

Ky komision do të përmbajë në vete hetimin e krimeve për një periudhë të caktuar. Do të thotë periudha do të jetë nga viti 1991 deri në vitin 2001 kur edhe përfundon me luftën në Maqedoni.

Ky trup nuk mund askënd ta gjykojë. Pra, nuk do t'i zëvendësojë gjykatat. Ky trup do të ketë mundësinë me i emëruar krimbërësit. Mi emëruar ata të cilët kanë bërë krime dhe veprat e tyre. Prandaj, ky trup mundet edhe të rekomandojë për reparacione si ato materiale ashtu edhe simbolike për vetë viktimat të cilat janë të harruara pas luftës nga qeveritë. Ky trup do të ketë mundësi të rekomandojë edhe kërkim-faljen, do të ketë mundësinë të rekomandojë ndërtimin e përmendoreve e tjera.

Prandaj, unë nuk do të kisha zgjat më shumë sepse këto konsultime janë të dedikuara për ju. Unë tash do t'ia kisha dhënë fjalën Norës e cila do të na tregojë për rrjedhën e procesit në Kosovë dhe në rajonin e ish-Jugosllavisë, pastaj edhe do ta shfaqim një film të shkurtër i cili do të tregojë rastin e Komisionit të Perusë pak a shumë që ta kemi në të materializuar atë se si mund të duket një komision në vende të ndryshme që kanë ekzistuar më herët, e që do të thotë se kjo nuk do të kemi të njëjtën. Pas kësaj, do të hapet tema e diskutimit që është një hapësirë për juve dhe kur ju mund t'i thoni të gjitha ato çka mendoni dhe do të mund të tregoni përvojat tuaja dhe për atë se çka do të kishte dashur të përfshihet në këtë komision, për cilat krime e tjera.

Unë ju falënderoj shumë dhe ia jap tash fjalën Nora Ahmetajt.

**Nora Ahmetaj:** Faleminderit! Unë ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe posaçërisht falënderoj veteranët e luftës, ish-luftëtarët, viktimat, familjarët e të zhdukurve sepse ata janë viktimat dhe ata janë pjesë e shoqërisë civile e cila më së shumti janë të prekur nga konflikti që ka ndodhur në Kosovë e po ashtu edhe nga konfliktet në ish-Jugosllavi. Kjo nuk do të thotë se nuk i falënderoj edhe të tjerët të cilët kanë marrë pjesë nga se pa pjesëmarrje të gjithë shoqërisë civile kjo iniciativë nuk do të kishte sukses.

Unë e di që lidhur me këtë komision, i keni marrë disa materiale për t'i lexuar dhe këto materiale do të keni mundësi t'i lexoni edhe pasi të kryhet ky debat dhe për të mos ju ngarkuar shumë me informata të cilat ndoshta janë për ne të njohura, ngase ne marrim pjesë në këtë proces që dy vite, e ndoshta për ju nuk janë aq të njohura, unë do të mundohem edhe t'i zërthej disi dhe të ju tregoj pse është parë e nevojshme të formohet ky komision rajonal dhe pse quhet komision dhe a thua po ndodh diçka këtu në rajon a në Kosovë, në rajonin e ish-Jugosllavisë ose në rajonin e Ballkanit perëndimor, ta quajmë ashtu, si të domi dhe a thua po ndodh diçka çka s'ka ndodhur në vende tjera të botës, në vende postkonfliktuale ku kanë ndodhur ose konflikte brendapërbrenda shtetit ose konflikte në mes dy shteteve.

Është fakt se ky komision është i pari në botë rajonal, nga se prej një shteti siç ka qenë Jugosllavia, kanë derivuar, kanë dalë shtatë shtete tjera, kështu që edhe është rajonal. 25 komisione tjera në botë që ekzistojnë janë nacionale, kryesisht, përveç komisioni për krime të luftës dhe pajtim po më duhet kështu quhet që është në Timorin Lindor dhe është

komision që është themeluar me ndihmën e Kombeve të Bashkuara mes Indonezisë dhe Timorit Lindor.

Ta lëmë anash një herë formimin e tij, sepse nuk po dua të ju ngarkoj me informata se çka bëjnë dhe si janë formuar këto komisione në botë, që ka shumë të tilla, mirëpo po dua ta thjeshtësoj se pse është parë e nevojshme të formohet diçka e tillë në rajonin ku ka pasur luftëra të përgjakshme dhe brutale në 15 vitet e fundit.

Konflikti në Bosnje është kryer qe 15 vjet. Konflikti në Kroaci është kryer gati qe 18 a 20 vjet. Konflikti në Kosovë, ose lufta, le ta quani së të doni, mos ma zini për të madhe nëse them konflikt a luftë, po unë po i përdori të dyja edhe atë teorike edhe atë çka ne jemi mësuar ta dëgjojmë. Edhe pas konfliktit në Kosovë, marrëdhëniet në mes shteteve në rajon, edhe pas 10 viteve, janë ende të ngrira. Nuk po hy në aspektin politik me thënë që Serbia dhe Kosova nuk kanë ende marrëdhënie për arsye se nuk po njihet identiteti i njëres prej palës tjetër. Mirëpo janë të tendosura marrëdhëniet dhe gjykatat për krime të luftës, sikur që është Gjykata Speciale për Krime të Luftës në Serbië, është në Kroaci. Krimet etnike, që kanë qenë të hulumtuara dhe të udhëhequra prej ndërkombëtarëve kryhen në Kosovë mirëpo krejt popujt të cilët kanë dalë nga luftërat në ish-Jugosllavi i kanë të vërtetat e tyre dhe secili e ka të vërtetën e vet, secili thotë unë kam qenë viktimë dhe tjetri ka qenë kriminel dhe dhunuesi.

Ndërkohë që gjykatat janë të stërngarkuara, janë shumë të ngarkuara me lëndë, kur ia jep këtë si shtesë lëndën për krime të luftës, atëherë ne e dimë që kemi mungesë të sundimit të ligjit dhe këtë nuk po e them vetëm në Kosovë, nuk është situata më e mirë as në Serbi, as në Kroaci, as në Bosnje, në Mal të Zi a në Maqedoni. Në Slloveni është pak më ndryshe. Mirëpo, ta cekim, në këtë formim të komisionit rajonal janë të involvuar edhe Maqedonia edhe Sllovenia. Edhe ato kanë qenë të involvuara në konflikt, kështu që të gjitha shtetet të cilat kanë qenë pjesë përbërëse e Jugosllavisë tash janë pjesëmarrëse, po mendoj jo shtetet, por shoqëritë civile nga se ideja ka ardhur prej poshtë, ideja ka ardhur që shoqëritë civile të iniciojnë formimin e këtij komisioni i cili do të përbëhet prej komisionarëve të pavarur të secilit vend dhe të cilët do t'i hulumtojnë shkeljet dhe abuzimet e të drejtave të njeriut në të gjitha luftërat që kanë ndodhur. Prandaj, mandati i komisionit është përcaktuar dhe kohëzgjatja për hulumtimin e shkeljeve të drejtave të njeriut që kanë ndodhur në këtë rajon të jenë nga viti 1991 deri 2001.

Pra, ideja ka qenë e organizatave joqeveritare nga rajoni, por më duhet të cekim, nën mbikëqyrje shumë të afërt prej Qendrës ndërkombëtare për të drejtën transitorë që është në Nju-Jork dhe e cila kryesisht merret me formimin e komisioneve për zbulimin e krimeve të luftës ose që komisionet mund të quhen konform nevojave të atyre shteteve të cilat i formojnë. Ka komisione në botë të cilat janë formuar vetëm për zbardhjen e personave të zhdukur, ka komisione të cilat janë formuar vetëm për identifikimin e krimeve të luftës, ka komisione të cilat janë formuar vetëm për amnisti ose pajtim apo për gjetjen e së vërtetës, kështu që varet se si kanë vendosur shoqëritë civile, apo parlamentet dhe qeveritë me i formua ato komisione.

Përvoja ka treguar se në disa shtete, dhe sidomos në shtetet e Amerikës Latine, se disa komisione formohen prej qeverive me dekret, ose prej presidentit apo prej ekzekutivit ose prej parlamenteve. Disa komisione janë formuar, sikur ajo që ka qenë më e suksesshme, prej vetë shoqërisë civile ku shoqëria civile e ka parë të arsyeshme kryesisht organizatat për të drejtat e njeriut me i formua dhe të kërkojë që qeveria pastaj ta legjitimojë. Komisionet nuk i formojnë shoqëritë civile. Shoqëria civile jep mendimet, mund t'i japë

idetë se çfarë shkelje të drejtave të njeriut duhet me u identifikua, duhet me u hulumtuar kur të përpilohet mandati i komisionit. Mirëpo, shoqëria civile i dorëzon, ia jep idenë parlamentit dhe parlamentet janë të vetmet entitete, legjitime, të cilat kanë të drejtë dhe mund të formojnë komisionet eventualisht siç e ceka konform politikave të një shteti dhe munden edhe presidentët me dekret. Mirëpo, në rajonin e Ballkanit është vendosur që idetë të vijnë prej poshtë, do të thotë prej shoqërisë civile, të mblidhen sugjerimet, sikur ky që është sot që e ka qëllimin të marrë ide prej jush, të shoh se a pajtoheni apo nuk pajtoheni me formimin e atij komisioni, çka kishit mund të përfitoni ju si viktimat dhe ato sugjerimet tuaja me u marrë parasysh kur të përpunohet mandati. Shoqëria civile e bën grupin e ekspertëve që do të jetë i përfaqësuar prej secilit shtet në mënyrë proporcionale në përpilimin e mandatit të komisionit dhe ia dorëzon qeverive në rajon. Shoqëria e Kosovës ia dorëzon Parlamentit eventualisht Qeverisë së Kosovës dhe kështu bëjnë edhe të gjitha qeveritë tjera. Mandej i mbetet parlamenteve ta diskutojnë këtë punë a bën a s'bën, a duhet a s'duhet dhe nëse parlamentet e aprovojnë, shoqëria civile prapë e merr rolin e mbikëqyrësit dhe e mbikëqyrë a po punon parlamenti konform atij mandati ose komisioni që e kemi propozuar.

Çka përmban ose, çka ishte dashur të përmbajë mandati? Përvoja e komisioneve tjera na tregon që ky komision nuk i zëvendëson gjykatat. Për dallim prej gjykatave, të cilat, edhe po që se e merr viktimën dhe e merr dëshmitarin, e ka kryerësin e veprës ose kriminelin përpara dhe mundohet ta zbardhë ose gjykojë rastin ky komision merret kryesisht vetëm me viktimat. Viktima është prioriteti, alfa dhe omega e këtij komisioni. Viktima do të dëshmojë, me viktimën do të punohet shumë afër dhe në kohëzgjatje e nëse është e nevojshme dhe me psikologë dhe viktimat do të japë mendimin e vet dhe do ta tregojë ngjarjen ashtu si ka ndodhur.

Për dallim prej gjykatave ku viktimat mund të traumatizohen shpeshherë ngase në gjykata dihet se kryerësi i veprave ka të drejtën ta ketë avokatin dhe ai ta mbrojë, ndërsa viktimat i nënshtrohet për të dytën herë, të tretën herë traumës, në këto komisione viktimat dëgjohet deri në fund dhe me viktimën solidarizohet. Qëllimi pra është se ky komision del me rekomandime dhe qeveritë atëherë janë të obligueshme që rekomandimet t'i zbatojë, në një afat qoftë 3, 5 po edhe më shumë vjet, ose ndodhë edhe më shumë, varësisht prej kohëzgjatjes së punës së komisionit, viktimat do të përfitojë edhe dëmshpërblimin ngase shtetet janë të obliguara por edhe do t'i kthehet dinjiteti. Me çka merret atëherë ky mandat? Mandati i komisionit e ka kohëzgjatjen dhe nuk preferohet me u marrë më këtë më shumë se 3 vjet, por kohëzgjatja edhe e përcakton volumin e punës. Në strukturën e komisioneve zakonisht inkuadrohen ose preferohet të jenë komisionarët njerëz me respekt, të dinjitetshëm dhe të respektueshëm në shoqërinë e vet. Parashihet të jetë një numër i madh i voluntarëve të cilët po ashtu do të inkuadrohen në mbledhjen e fakteve, në mbledhjen e analizave dhe sistemimin e fakteve, por vullunterët nuk do të thotë se ata do të punojnë pa pagesë. Parashihet që të punojë gjithashtu ekipi i psikologëve, ekipi i ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare dhe të gjithë duhet të jenë të pavarur dhe shumë profesionalë në punën që e bëjnë.

Cekëm në fillim se kohëzgjatja për hulumtimin e krimeve të luftës në këto treva është marrë prej 1991 – 2001, ashtu sikur që ka filluar edhe Tribunali i Hagës të merret me krimet e luftës që prej kur ka filluar lufta në ish-Jugosllavi deri në përfundimin e luftës – të konfliktit në Maqedoni. Mirëpo, se me çfarë shkelje të drejtave të njeriut do të përfshijë ky mandat i komisionit do të varet edhe prej sugjerimeve që ju do t'i bëni dhe



që i bëjnë shoqëritë civile në gjithë rajonin. Për shembull, në komisionin e parë që është formuar në Argjentinë janë hulumtuar vetëm humbjet e njerëzve, apo zhdukja e personave dhe ai komision ka punuar vetëm 9 muaj, mirëpo nëse marrim për shembull në Çile ose Kili një komision tjetër ka qenë me kohëzgjatje më të gjatë, atëherë shkelja e të drejtave ka përfshirë jo vetëm zhdukjen por edhe vrasjen, burgosjet, largimin nga puna e të gjithë qytetarëve të cilët nuk kanë qenë përkrahës të regjimit të Pinoçes i cili ka qenë pothuaj i njëjtë me regjimin e Millosheviqit. Do të thotë mandati përcakton edhe kriteret edhe kohëzgjatjen dhe krimet të cilat duhet përfshirë në hulumtim deri sa të zgjasë puna e komisionit në rajon. Nëse, për shembull, shoqëria civile e Kosovës thotë ne po domi që në mandatin e komisionit ta fusim kërkim-faljen nga se Serbia duhet të kërkojë falje për atë çka ka bërë këtu, ose nëse Bosnja, për shembull kërkon që në mandat të komisionit të hyjë një shkelje tjetër – e dhunimit të grave për shembull në Bosnjë ose në Kroaci, apo Serbia mund të kërkojë të hulumtojë zhdukjen e personave ose të serbëve në Kosovë. Këto janë të gjitha shkelje të drejtave të njeriut të cilat do të hyjnë dhe do të ishte dashur të hyjnë të analizohen pasi të propozohen nga shoqëria civile se çka do të përfshihet në këtë mandat.

I përmendëm shkaqet dhe kohën, metodologjia e punës së këtyre komisioneve, çka do të përfshijnë dhe sa komisionarë duhet t'i kenë këto komisione, sa persona duhet të punojnë. Kjo do të varet prej buxhetit, do të varet se sa komisionarë do t'i ketë secili vend në rajon dhe sa punë do të ketë gjatë hulumtimeve në atë rajon, por edhe ajo do të varet konform shkeljeve të cilat janë kryer në atë rajon dhe atë shtet. A do të jetë, për shembull regjistrimi i viktimave të luftës, regjistrimi i të zhdukurve, si do të hulumtohen të zhdukurit, si të hulumtohen se sa ka pasur viktimat të luftës, sepse viktimat e luftës zakonisht i dimë me numra por nuk janë me emra dhe zakonisht thuhet 12.000 – 13.000, thuhet 20.000 – 30.000 gra të dhunuara, por komisioni e ka për qëllim me dalë me emër e mbiemër dhe komisioni përveç burimeve primare që do të dalë vetë t'i hulumtojë dhe ta gjejë viktimën dhe atë ta dëshmojë, do të bazohet edhe në të dhënat e organizatave relevante për të drejtat e njeriut, do të bazohet edhe në të dhëna tjera të organizatave ndërkombëtare dhe lokale, do të bazohet në media. Do të thotë, kur të merret të analizohet një dëshmi nuk do të merret vetëm dëshmitari por do të hulumtohet shumë edhe për zbardhjen e një rasti deri të zgjidhet si rast definitiv me dëshmi të saktë.

Cilat ishin kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit. Shkurt, e përmenda në fillim se njerëzit të cilët do të janë anëtarë të komisioni do të jenë të propozuar nga ju. Shoqëria civile i propozon ata persona dhe lidhur me këtë po përmendi rastin e Afrikës së Jugut kur Nelson Mandela ka kërkuar listën e personave të cilët do të hyjnë në rizgjedhje për tu bërë komisionarë të Komisionit për të vërtetën në Afrikën e Jugut i është dorëzuar një listë shumë e madhe – diku prej 200 vetëve por Afrika e Jugut është shtet shumë më i madh se Kosova, pastaj ajo listë është zvogëluar dhe filtruar në 50 vetë, e pastaj edhe për 25 vetë deri sa është filtruar në numrin 7 të personave të cilët kanë qenë komisionarë. Në Argjentinë, për shembull, kryetari i Komisionit ka qenë një shkrimtar shumë i njohur, i pa anshëm, i cili ka qenë shumë i respektueshëm në shoqërinë e vet dhe i cili e ka kryesuar punën e Komisionit. Komisionet që punojnë në afat më të shkurtër janë më efektive. Komisionet që kanë afatin më të gjatë të punës, normalisht se do të varen edhe prej menaxhimit se kush do të jetë krye-komisionar dhe kush do të jetë ai person dhe sa do të jetë ai ta menaxhojë punën e këtij komisioni.

Nuk e ceka dëgjimin publik. Kur fola për dëshmitarët në momentin kur vendoset për hulumtim të një krimi dhe gjenden dëshmitarët, me ta, nuk e di se a ka pasur ndokush prej juve të jetë dëshmitarë në Tribunalin e Hagës dhe ne zakonisht po kemi nëpër konsultime disa dëshmitarë dhe ata kanë përvojë se si punohet kur të shkohet për të dëshmuar dhe edhe pse në mënyrë pak më sipërfaqësore punojnë psikologët me ata dëshmitarë. Në dëshmitë e dëshmitarëve që kanë përjetuar trauma dhe të cilët kanë parë se si u janë vra familjarët ose kanë parë duke iu masakruar familjarët, apo gratë e dhunuara, punohet në mënyrë shumë-shumë të detajuar dhe të afërt me psikologë. Psikologët punojnë në kohë shumë të gjatë me dëshmitarët para se ata të përgatiten për të dëshmuar.

Një efekt tjetër që dua të cek këtu, është se përveç që dëshmitarët përgatiten të dëshmojnë, vendoset paraprakisht për atë se a do të dëshmojnë dëshmitarët në publikë apo dëshmimi të jetë i mbyllur. Ka shtete, për shembull El Salvadori ka pasur një regjim jodemokratik kur është formuar komisioni dhe atëherë dëshmitarët nuk kanë guxuar të dalin e të dëshmojnë në dëgjim publik, por këtë e kanë bërë në mënyrë të mbyllur. Mirëpo, efekti i dëgjimit publik është parë më së miri në Komisionin të Afrikës Jugore ku dëshmitarët përfaqësohen në nëntë TV kanale kryesore të Afrikës Jugore i kanë paraqitur dëshmitë në kanale televizive dhe i gjithë populli i Afrikës së Jugut e ka pa çka ka ndodhë dhe çka ka bërë regjimi i aparteidit. Mirëpo aty kanë dëshmuar edhe dëshmitarë të cilët kanë qenë viktimat të njëjësive guerile jugo-afrikane. Dhe kjo, e ka pasur efektin tjerë për arsye se gjeneratat e reja e kanë pa çka ka ndodhur në atë vend dhe e gjithë bota e ka pa, të gjithë gazetarët më eminentë të botës kanë qenë prezentë dhe të gjithë e kanë parë se çka ka bërë regjimi i aparteidit në Afrikë.

Efekti i dëgjimeve publike është shumë i madh, mirëpo kjo varet edhe prej specifikave të rajonit. Për shembull gratë e dhunuara në Bosnjë ose në Kosovë vështirë kishin të pranojnë të dalin të dëshmojnë publikisht dhe nuk preferohet dhe për këtë psikologët duhet të punojnë shumë me ato gra dhe mbetet pikëpyetje se a pranojnë apo nuk pranojnë ato të dëshmojnë publikisht. Këto janë tema shumë të ndjeshme dhe me këtë diskutohet por paraprakisht vendoset para se dëshmitari të vendos vet, eventualisht me ndihmën e psikologëve se çka duhet të bëjnë nëse vjen puna deri te dëshmitë.

Është edhe një çështje shumë e ndjeshme te amnistia. Ndoshta gjatë diskutimeve, ju do të bëni pyetje dhe atëherë do të diskutojmë më mirë lidhur me problemin e amnistisë, problemin e kërkimit të faljes. Këto janë dy tema shumë të ndjeshme por janë edhe si koncepte shumë filozofike dhe mund të kuptohen në mënyra të ndryshme. Për shembull komisioni mandat për komisionin e së vërtetës të cilat e parashohin që një kriminel i luftës të vjen dhe ta tregojë, shembull, që ka kryer krim, por me rastin kur ai tregon se ka kryer krim dhe eventualisht tregon se ku është bërë ai krim, atij pjesërisht mund t'i falet dënimi, po e zëmë rastin këtu. Në Afrikë të Jugut ka pasur sukses për arsye se ka pasur dëshmitarë të cilët kanë treguar çka kanë bërë por në një farë mënyre viktimat ka vendosur çka të bëhet me ata dëshmitarë, a të amnistohet për krimin e bërë, apo pjesërisht me ia falë apo të dënohen. Kemi këtu rastin dhe mund ta konvertojmë me rastin e Kosovës, për shembull. Për këtë nuk do të kërkoj përgjigjen, por për këtë mundemi të diskutojmë më vonë. Për shembull vjen një person dhe thotë – unë e di ku ka ndodhur krimi ose unë e di ku janë varrezat masive, unë e di ku ka ende të zhdukur dhe çka po më ofroni ju mua nëse unë për shembull ju tregoj ku qëndron ajo varrezë masive apo eventualisht ku janë eshtrat e atyre persiane të zhdukur. Këtë po e prek vetëm si temë për

diskutim dhe se sa na intereson mendimi juaj dhe pastaj çka kishit të bëni në atë moment, çka kishit për të thënë, për të sugjeruar. Këto janë ato temat e ndjeshme të cilat nuk mund t'i marrim të formatit të kryera dhe me thënë – ka ndodhur në Argjentinë dhe në Afrikën e Jugut, ka ndodhur në Maroko – duhet me ndodhë edhe këtu. Jo, absolutisht sepse secili vend i ka specifikat e veta. Ne mund të marrim leksione prej përvojave të shteteve tjera, të shohim çka është mirë e çka keq, por nëse vjen deri te formimi, do të jetë komision rajonal dhe atëherë me siguri puna në këtë komision do të jetë shumë më e komplikuar në krahasim me komisionet tjera meqë këtu janë të implikuara 7 shtete e jo vetëm një shtet. Tash mundeni me marrë me mend vetëm gjatë konsultimeve sa ka punë dhe sa ka mosmarrëveshje se si të kryhen konsultimet në një shtet, për dallim prej shtetit tjetër dhe paramendoni kur të vjen puna që të ulen të gjithë komisionarët nga shumë shtete e të ulen rreth tavolinës për të vendosur për shembull se cili krim të hulumtohet, çka të hulumtohet dhe cilin përfundim ta marrin.

Dhe, në fund do ta përmendi edhe këtë se ky komision kur ta përfundojë punën dhe po e zëmë se e ka mandatin 3 vjet. Mos të harrojmë se këto komisione, nëse parlamenti vendos për formimin e këtij komisioni, parlamenti do ta bartë barrën e financimit dhe aq sa ka mundësi të financojë aq do të jetë edhe efektiv dhe ekspeditiv puna e komisionit. Mirëpo, në momentin kur komisioni e përfundon punën dhe ne shpresojmë se do ta përfundojë punën dhe del me rekomandime, ato rekomandime nuk do të jenë të domosdoshme për t'u zbatuar me përpikëri mirëpo nuk ka ndonjë organ i cili i shtynë shtetet ose ndonjë arbitër i cili i shtynë shtetet që patjetër t'i zbatojnë këto rekomandime. Ka komisione në botë, rekomandimet e të cilave, nuk janë zbatuar ende, por ka edhe komisione të cilat për arsye të mungesës së financave rekomandimet e atij komisioni nuk kanë mund të zbatohen. Lidhur me këtë, kemi rastin edhe të Afrikës së Jugut, ku Ministria e Financave ka thënë ne po dimë se viktimave i janë caktuar këto reparacione, ata duhet t'i marrin këto dëmshpërblime, një shumë të caktuar të hollave për çdo muaj, mirëpo Ministria e Financave nuk ka mund me i përballuar dhe i ka lënë. Mirëpo, efekti tjetër, në Afrikën e Jugut ka qenë sepse ka bërë jehonë shumë të madhe në botë dhe viktimat janë pajtuar, e kanë parë që në njëfarë mënyre i është kthyer dinjiteti. Mirëpo, për shembull në Argjentinë ose në Çile komisioni ka pasur sukses për arsye, në Çile, për shembull jo vetëm që viktimat të cilat kanë qenë direkt të vrarë ose të persekutuar prej regjimit të Pinoçesë i janë kthyer ose kanë fituar reparacione, dëmshpërblime, por edhe ata të cilët e kanë humbur punën, ata të cilët kanë qenë të torturuar, ata të cilët kanë përjetuar dhunë sistematike – edhe atyre u janë bërë dëmshpërblimet. Ka kaluar një kohë pesëvjeçare ose më e gjatë, por megjithatë e ka vlerë barra qiranë.

Edhe një herë të them se këto komisione do të financohen kryesisht prej organit i cili i legjitimon. Në këtë rast në të gjitha vendet e rajonit po edhe në Kosovë është dashur t'i bëjë parlamenti, dhe parlamenti ishte dashur ta bartë barrën kryesore. Mirëpo, këtu nuk largohet mundësia që edhe bashkësia ndërkombëtare ndoshta të intervenojë me ndihma simbolike, por kjo do të varet edhe prej kërkesave tona. Ndodh që qeveritë në rajon do të thonë, na jemi shumë të varfër dhe nuk kemi mundësi t'i mbulojmë shpenzimet e punës së komisionit, kurse për reparacione atëherë vendoset që, nëse krimet i ka kryer Serbia, atëherë është dashur Serbia me i pagua dëmshpërblimet, por puna e komisionarëve do të kushtojë shumë. Kohëzgjatja, vendi, pastaj hulumtimet do të kushtojnë shumë. Këto janë disa gjëra të cilat do t'i diskutojmë më vonë, nuk po ju ngarkoj me më shumë informata. Përafërsisht kjo ishte, por do ta përmendja edhe punën e pajtimit. Punën e pajtimit, e di

që në disa konsultime, as nuk e prekim këtë temë dhe ky komision quhet komision për të vërtetën dhe krimet e luftës në ish-Jugosllavi dhe është vendos që do të quhet ashtu, por ishte dashur që së paku për hir se ne vetëm fillojmë ta përpilojmë mandatin e komisionit, me i dëgjua mendimet tuaja dhe mos hezitoni të thuani krejt çka mendoni, qoftë për ose kundër këtij komisioni në mënyrë që çdo sugjerimi i juaj është shumë-shumë valid dhe merret parasysht. Ju faleminderit shumë!

**Isuf Halimi:** OK. Faleminderit shumë! Besarta, faleminderit! Faleminderit Nora! Tash kemi një film që do të shfaqet dhe ka të bëjë me Komisionin në Peru, do të thotë një prej shembujve është. Dhe, para se ta lëshojmë, Albana ju kisha lutur që le të ndalen dritat. Po, patjetër! Urdhëroni, por prezantohuni edhe një herë.

**Hamit Ademaj:** Jam Hamit Ademaj, kryetar i Shoqatës së familjeve të dëshmorëve. Ju përsërites të gjithëve. Në radhë të parë kërkoj falje për agjendën që kam dhe se shumë dëshirë kisha pasur që të rri dhe falënderoj zonja Nora për sqarimet që i dhatë dhe për këtë më vjen mirë. Mirëpo, kisha preferuar dhe kisha qenë shumë në gjendje gatishmërie që në emër të Shoqatës së familjeve të dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – dega në Prizren të ju uroj punë të mbarë dhe suksese në të ardhmen dhe ky komision qenka dashur të formohet dhe të themelohet shumë vite më herët dhe thuhet një fjalë popullore – më mirë vonë se kurrë dhe ta keni parasysht bashkëpunimin e Shoqatës sonë, jemi në gjendje gatishmërie çdo herë dhe ju mirëpresim.

Desha vetëm një vërejtje të vogël kisha me pasur te zonja Nora që po ma përziën shumë emrin për “konflikt” dhe “luftë”. Konflikti duhet të shlyhet si term dhe të zëvendësohet çdo herë me emrin luftë, sepse të gjithë e dimë – qytetarët tanë, vendasit tanë, fqinjët tanë dhe ndërkombëtarët e dinë shumë mirë se luftë ka qenë në Kosovë dhe në të gjitha këto shtete të reja të Jugosllavisë së shkatërruar. Them se çdo herë duhet të përmendet luftë, sepse konflikt është sikur një përleshje fizike në mes ne dyve dhe në fund ia japim dorën njëri-tjetrit. Kështu që, kjo ka qenë luftë dhe mos t’i shmangemi këtij termi. Pra, të zëvendësohet çdo herë me luftë.

Edhe një herë ju uroj suksese dhe dëshiroj që ky komision të formohet sa më shpejt dhe të funksionojë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Mos ta harroj edhe një fjalë dhe do ta them se familjet e dëshmorëve, disa, të cilët nuk i kanë fëmijët e vetë – dëshmorët e gjetur, ato bëjnë vizita nëpër vizita të dëshmorëve dhe qajnë për atë se nuk e kanë djalin në varrezat e dëshmorëve. Nuk qajnë për arsye se iu ka vvarë djali, por qajnë pse nuk e kanë djalin në mesin e shokëve të tyre. Prandaj, ky komision duhet të jetë shumë serioz, i aftë dhe të punojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Ju përsërites, faleminderit!

**Isuf Halimi:** Faleminderit! Albi?

**(Shfaqja e filmit)**

**Besarta Vasija:** Nëse mundemi, do të vazhdojmë. Do të thotë, ky ishte një film dokumentar rreth Komisionit të Perusë, prandaj ne, sikur që e thamë edhe më herët, është ky vetëm një shembull i cili nuk do të thotë se ne duhet të bazohemi në këtë shembull, pasi që në botë kanë ekzistuar afërsisht 47 komisione të tjera, që disa prej tyre kanë qenë të suksesshme e disa tjera kanë dështuar, prandaj ne jemi munduar që në bazë të shembujve të marrim rastet pozitive të cilat mund t’i aplikojmë ne dhe rastet negative që ne të mos dështojmë sikur disa vende tjera.

Ne tani do të fillojmë me sesionin e diskutimeve. Mirëpo, së pari, unë desha të ju them se këto janë konsultimet e 11-ta me radhë në Kosovë që nga viti 2009 që në shumicën e

rasteve kemi pasur konsultime me shoqërinë civile në përgjithësi. Kemi pasur edhe konsultime me familjarët e viktimave, kemi pasur konsultime me familjarët e të zhdukurve, kemi pasur konsultime me Grupin e Grave nga Kosova, kemi pasur konsultime me studentë, kemi pasur konsultime me aktivistët e rinj që në fakt janë e ardhmja e vendit tonë, kemi pasur konsultime, po ashtu, edhe me grupe të ndryshme apo me kategori të ndryshme në përgjithësi prej vendeve të ish-Jugosllavisë.

Në të shumtën e konsultimeve, si në Kosovë ashtu edhe në vende tjera në rajon, nevoja e parë e viktimave dhe e shoqërisë në përgjithësi, pasi që viktimat nuk janë vetëm ata që janë prekur direkt por jemi shi shoqëri të gjithë viktima, nevoja e tyre e parë ka qenë që të zbulohet fati i të zhdukurve, pra i familjarëve të tyre.

Prandaj, si kërkesë primare me të cilën duhet të merret komisioni – KOMRA apo të cilën duhet ta hulumtojë KOMRA ka qenë – zbulimi i fatit të zhdukurve, zbulimi i varrezave masive në vende të ndryshme.

Një tjetër kërkesë ka qenë, sikur e përmendi edhe Nora më herët, ajo nga grupet e grave, si në Kosovë ashtu edhe në rajon, ka qenë që si krim lufte të hetohen edhe dhunimet seksuale të femrave të cilat janë përdorur si mjet nga krim-bërësit, si një krim lufte.

Po ashtu, kemi pas konsultime rajonale edhe me ish të burgosurit dhe me llogorashët nga Bosna e Hercegovina, nga Kroacia dhe Serbia, të cilët fatmirësisht ne nuk i kemi pasur, por kjo nuk do të thotë që ish të burgosurit tanë nuk i kanë përjetuar traumat dhe maltretimet e njëjta. Prandaj, nga kjo kanë dalë edhe rekomandimet që në fakt ky komision duhet të merret edhe me këto krime.

Po ashtu, një nevojë tjetër e viktimave ka qenë që ky komision të merret edhe me torturat si ato fizike ashtu edhe psikike.

Pra, tani unë do të doja ta hapim diskutimin, së pari me këtë se çka mendoni ju, përveç me këto krime, edhe me të cilat krime ishte dashur të merret ky komision.

Ne ju kemi shpërndarë edhe disa tekste ku janë temat e diskutimit. Janë disa pika, të cilat ne ua kemi dërguar me ftesë, për të parë se për çka mund të diskutojmë dhe në bazë edhe të përvojave tuaja të marrim edhe shembuj të tjerë.

Ju kisha lutur të gjithëve të jeni të relaksuar, pra edhe nëse keni diçka kundër, edhe nëse keni diçka pro, po edhe nëse keni pyetje e rekomandime – të ndiheni të lirë dhe lirshëm të flisni. Kjo është hapësirë për ju, prandaj ne mendojmë se ju duhet të flisni, pa marrë parasysh se a na përkrahni apo jeni kundër kësaj ideje.

Andaj, kushdo që do dëshirë të marrë fjalën, ju kisha lutur që, secili që flet, le të prezantohet, për shkak se kjo dokumentohet, kjo transkribohet dhe për të na mbetur një dokument nga ky konsultim ne na duhet që secili njeri që flet të prezantohet me emër e mbiemër, sa herë që ta marrë fjalën. Urdhëroni, zotëri Bylbyl!

**Bylbyl Duraku:** Jam Bylbyl Duraku. Unë do të isha pajtua me këtë komision po qe se kishte me pas një lloj qëndrimi ky komision për të ditur kush është shkaktari kryesor i këtyre krimeve apo të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Pra, do të isha pajtua dhe do të kisha punuar... Mirëpo, unë vetë si viktimë e luftës nuk isha pajtua të nënshkruaj peticion dhe ai peticion me shkua në Parlamentin e Serbisë tash në këtë përbërje qysh është. Ndoshta, pas 5 apo 10 vitesh dhe nëse do të kishte forca liberale apo forca njerëzore që e marrin pushtetin në Serbi, atëherë po. Përndryshe, në këtë gjendje çfarë është tani, unë mendoj që as serbët vetë nuk do të pajtohen të marrin pjesë në këto komisione. Edhe unë personalisht, për deri sa ky komision që po i thoni regjional nuk merr qëndrim që

shkaktari kryesor i luftërave është shteti i Serbisë, unë nuk mendoj se do të ketë sukses ky komision.

Edhe diçka tjetër. Për cilat periudha kohore është fjala? A është vetëm për të drejtat e njeriut, a është edhe për krime të luftës dhe pse është vetëm prej 1991 kur dihet se, s'po them tash prej 1945-tës por qe një kohë më të gjatë, shqiptarët do të thotë janë të vetmit viktima, do të thotë, në ish-shtetin e Jugosllavisë, kurse luftërat në mes kroatëve e serbëve dhe boshnjakëve e serbëve kanë filluar tek të 90-tave. Kaq.

**Besarta Vasija:** Faleminderit, zotëri Bylbyl! Nora Ahmetaj, do të përgjigjet.

**Nora Ahmetaj:** OK, Bylbyl dhe të tjerët! Kërkoj falje se u deshtë të flitet qysh në fillim lidhur me shkaqet e luftës dhe është pyetje shumë me vend. Konsultimet që bëhen në rajon qe 3 vite gati, kryesisht si temë më të diskutueshme e cila ende do të diskutohet dhe është shumë-shumë më intriguese – është çështja e shkaqeve të luftës. Pothuaj se të gjitha shoqëritë civile në rajon kërkojnë që në mandat të komisionit të specifikohen shkaqet e luftës dhe është duke u debatuar në mënyrë shumë të nxehtë lidhur me këtë temë. Ne e dimë që, po të kërkohej shkaqet e luftës, secili shtet ose secila qeveri do t'i kishte arsyetimet e veta mirëpo shkaqet e luftës, nëse veç po e sugjeroni, të shohim edhe të tjerët çka do të sugjerojnë. Ndoshta edhe do të jetë temë kryesore, ose jo si temë kryesore, por do të jetë patjetër një temë që do të hyjë në mandat të komisionit.

**Bylbyl Duraku:** Duhet të dihet kush është agresori, kush është viktima. Viktima nuk mund të ndihet mirë nëse barazohet me agresorin. Kjo është! Kjo po i bie se të gjithë kanë bërë krime dhe krejt në rregull – falni ato çka kanë ndodhur ndaj juve dhe kurrëgjë askujt.

**Nora Ahmetaj:** OK. Unë nuk paragjykova, unë vetëm thash se është temë më e diskutueshme dhe shkaqet e luftës do të hyjnë në mandatin e komisionit, ndërsa tema juaj tjetër ishte për peticion. Këtu nuk bëhet fjalë për peticion dhe nuk do t'i dërgohet parlamentit të Serbisë peticion. Jo, qëllimi është me u mbledhur 1 milionë nënshkrime. Dhe, e dini pse me u mbledh 1 milionë nënshkrime? Nga se, vetëm me 1 milionë nënshkrime Parlamenti Evropian e diskuton atë temë dhe kur e diskuton Parlamenti Evropian atë temë atëherë mundet me një rezolutë të përbashkët të Parlamentit Evropian me iu dorëzuar qeverive të vendeve në rajon, të cilat atëherë ato duhet ta lëvizin këtë çështje. Mirëpo, qeveritë në rajon edhe më ma pak nënshkrime debatojnë. Për shembull Parlamenti i Kosovës me 10.000 nënshkrime ka të drejtë të debatojë një temë. Mirëpo, 1 milionë nënshkrime mblidhen prej të gjithë rajonit, nëse do të ketë sukses ky proces i konsultimeve, në mënyrë që t'i dorëzohet Parlamentit Evropian.

Dhe, pyetja e tretë, ishte lidhur me? Po, edhe kjo ishte shumë me vend. Pse vetëm prej vitit 1991? Unë kur ceka kohëzgjatjen dhe mandatin e komisionit, është marrë kryesisht se kur kanë filluar luftërat në Jugosllavi dhe ato kanë filluar më 1990-1991, në 1992 kanë filluar në Slloveni, deri në 2001 në Maqedoni. Ju e keni sugjerimin tuaj shumë me vend e unë shpresoj se edhe të tjerët do të japin këso sugjerime nga se edhe para jush ka pasur familjarë të viktimave por ka pasur edhe përfaqësues tjerë të cilët kanë kërkuar që mandati të përfshijë kohëzgjatjen edhe të viteve të 80-ta kur ka pasur për shembull shumë të vrarë ose ushtarë të vrarë shqiptarë që kanë ardhur prej burgjeve në kufoma apo prej ushtrisë jugosllave. Dhe, kjo është e diskutueshme.

Mirëpo, unë e përmenda edhe punën e financimit. Kush do ta financojë, nëse kosovarët, për shembull, kërkojnë që kohëzgjatja e mandatit të jetë prej viteve 1980 deri në vitin 2001 – 20 vjet. Atëherë, ka pasur sugjerime në Bosnje të cilët kanë kërkuar që të kërkohej

çka është bërë me hebrenjtë në vitet e pasluftës së dytë botërore në Sarajevë dhe në Bosnje e Hercegovinë. Do të thotë secili shtet i ka kërkesat e veta. Nëse komisioni do të jetë ekspeditiv dhe domi për ta zbardhur një periudhë, e në këtë rast janë luftërat që kanë ndodhur në ish-Jugosllavi atëherë ne duhet patjetër ta bëjmë pyetjen – kush do t'i financojë. Dhe nëse Parlamenti i Kosovës nuk do të ketë mundësi të financojë gjithë atë kohëzgjatje, ne me siguri duhet të kërkojmë ndihmë, e nëse ti kërkon ndihmë, atëherë veç e dimë se kërkesa e ndihmës financiare ka edhe limite të mëdha, kështu që ka implikime dhe vetëm po dua të tregoj se ka implikime shumë më të thella se që ne mendojmë. Prandaj, te kohëzgjatja dhe mandati i komisionit, pa marrë parasysh si dëshirojmë ne dhe çka dëshirojmë ne të përfshijë ai komision, kur të vjen puna te financat, atëherë ma merr mendja se financimi do të ndikojë shumë edhe në punën e komisionarëve por edhe në hulumtimet dhe kohëzgjatjen e hulumtimeve.

**Besarta Vasija:** Vetëm edhe një plotësim rreth zgjatjes së kohës. Do të thotë nuk është herë e parë dhe nuk është vetëm ky rast që e përmendët. E kemi për shembull sugjerimin kur duhet të hulumtohen edhe rastet e helmimit të nxënësve që ka qenë në shkolla. Po ashtu, në konsultimet e fundit, ka qenë edhe një rekomandim tjetër kur një prind i cili i kishte fëmijët e vrarë ai ka kërkuar të hulumtohen edhe rastet e izolimit të familjeve me vite të tëra, do të thotë që janë bërë nga regjimi i Millosheviqit.

Është një problem tjetër që është parë si rrezik edhe nëpër vende tjera: sa më e gjatë është koha e hulumtimit të krimeve aq më shumë është rrezik të dështojë komisioni. Po, ky komision, çka mund të bëjë? Ky komision mund të japë rekomandime dhe të thotë për shembull po e marrim, i kemi hulumtuar varrezat masive, zbulimin e fatit të zhdukurve dhe të rekomandohet që të bëhet një komision tjetër, i cili kishte me u marrë, shembull, me rastet e viteve të 80-ta. Për shembull kemi edhe sugjerime kur thuhet që në kohën e Rankoviçit, për shembull, në Kosovë kanë ndodhur krime të tmerrshme, do të thotë shkelje e të drejtave sidomos te shqiptarët. Prandaj, nëse ky komision, për shembull rrezikon të dështojë nëse lëshohet do të thotë shumë mbrapa, atëherë mund të dalë si rekomandim të themelohet një komision specifik që do të ishte marrë me këto. Prandaj, ishte pyetja edhe barazimi i krimeve. Unë po mendoj që bash për shkak të asaj se ne nuk po domi me i barazua krimet, bash për shkak të asaj se ekzistojnë histori të ndryshme ku serbët nuk i pranojnë krimet e veta që i kanë bërë këtu dhe e shohin veten si viktimë. Ka edhe rast, unë e di vetë dhe kam pasur rast të takohem me njerëz në Serbi të cilët thonë: “Nuk është e vërtetë që kanë ndodhur aq shumë krime ose vrasje në Kosovë. Ne jemi viktima. Neve ju na keni vra, neve na keni përzënë nga shtëpitë tona”. Problemi është se propaganda ka qenë e tillë dhe nuk mund ju t’ia shihni për të madhe një njeriu se normalisht secili i beson asaj çka i afrohet në televizione. Ke shqiptarë që thonë: nuk është e vërtetë që janë vra për shembull serbë civilë, sidomos në periudhën 1999-2000. Po kjo, nuk do të thotë se nuk ekzistojnë ato. Prandaj, kjo nuk është barazim i krimeve. Pikërisht duhet treguar. Nuk mundesh t’i ta barazosh një krim dhe me thënë: uau, një numër sa janë vra. Ne i kemi do të thotë deri tash 13.000 në Kosovë, po e zëmë me 4.000. Kjo nuk mund të barazohet assesi. Vetë numri e tregon çka ka ndodhur. Absolutisht ne e dimë që pothuaj në të gjitha vendet, përveç edhe Maqedonisë, Serbia ka marrë pjesë në secilën luftë. Nuk mund kjo të zhduket, të mbyllet edhe pse Serbia ndoshta kishte pasur dëshirë me u mbyll kjo. Kjo nuk mund të mbyllet nëse ne hulumtojmë dhe kemi fakte dhe i themi: 13.000 veta janë vra prej policisë dhe ushtrisë serbe. A mundet këtë dikush me mohua? I kemi këto të dokumentuara.

Për një rast, ta marrim vetëm rastin e Bosnjes e Hercegovinës ku i kemi tri histori të ndryshme për një luftë të njëjtë. E kemi versionin e kroatëve, e kemi versionin e boshnjakëve dhe e kemi versionin e serbëve, besa edhe e kemi versionin e bashkësisë ndërkombëtare. Prandaj, secila prej komuniteteve e ndien vetën se është viktimë, kurse atë përballë e sheh si kriminel. Po nëse ne nuk kemi fakte, nëse ne nuk kemi dokumente, do të vazhdohet diçka e njëjtë dhe kush na siguron ne që pas 50 vjetëve nuk kemi me pasur edhe një luftë tjetër në Kosovë. Në Bosnjë e Hercegovinë, besoni se është gati prapë dhe është situata aq e tensionuar sa që nuk dihet kurrë çka mund të ndodhë. E, as Maqedonia, nuk i ka punët më mirë. Prandaj, duhet parandaluar dhe e vetmja mënyrë është që të mos lejohen njerëzit të lëshojnë gënjeshtër në opinion dhe të manipulojnë me numrin e viktimave, sikur bën sot edhe Serbia, qysh bëjnë edhe vende tjera. Prandaj, absolutisht unë mendoj se kjo le që nuk është barazim i krimeve por mendoj që është e vetmja mënyrë kur ne mund ta parandalojmë dhe ia kemi borxh gjeneratave të ardhshme t'i tregojmë se çka ka ndodhur vërtetë këtu. E kemi rastin e Luftës së Dytë Botërore ku ne nuk e dimë as sa viktima ka pasur këtu. Pse? Sepse kurrë nuk është shkruar. Kemi raste kur nuk e dimë a ka qenë shqiptarë a serb dhe çfarë nacionaliteti kanë qenë. Kjo është për arsye se nuk ka asgjë të dokumentuar. 11 vite po kalojnë prej luftës në Kosovë. Dhe, edhe 10 vite tjera kur kalohen do të mbyllet kjo çështje dhe kurrë s'kemi me ditë kush e sa kanë vdekur. Prandaj, mendoj se do të ishte mirë të dëgjohen edhe mendimet e të tjerëve.

Zotëri Bylbyl, deshe edhe një herë ta marrësh fjalën, a po. Apo, ju zoti Aqif?

(Ndërhyrje)

Jo, jo. Absolutisht! Kjo është e hapur, keni kohë sa të doni për propozime dhe kritika.

**Ejup Kabashi:** Mirë dita! Ju përshëndes të gjithëve. Jam Ejup Kabashi, kryetar i Organizatës së veteranëve – dega në Rahovec.

Unë së pari mbështes një iniciativë të tillë, megjithë gabimet dhe vërejtjet që mund t'i kemi edhe gjatë diskutimeve. Pa shmangshëm, ne – organizatat e dala nga luta, jemi marrë pas lufte me shumë gjëra të cilat vërtet është dashur t'i mbyllem disa plagë ose t'u jemi familjeve afër, atyre që i kanë humbur më të dashurit e vet.

Çka shoh unë këtu? Do të thotë prej fillimit pas lufte kam parë një zhgënjim të madh të organizatat ndërkombëtare që kanë vepruar lidhur me të drejtat e njeriut, kryesisht që janë marrë me tragjeditë e luftës në Kosovë. Ne i patëm pajisur me tonelata dokumentacione dhe argumente të fuqishme se në rajonin, që unë vi – nga Rahoveci, pa shmangshëm një rajon që ka pësuar më së shumti ndoshta në këtë pjesë dhe asnjëherë nuk është zbardhë, kriminelët janë të lirë, ende janë të lirë. Ne i kemi adresuar dhe i kemi çua edhe faktet se kush është kriminel dhe kush është kryerësi i veprës.

Këtu mundohet të hidhet dritë edhe për të gjitha ato që kanë ndodhur pas lufte – viti 1990-2000. Duhet të kemi parasysh se për çështje të sigurisë nuk kanë pasur shqiptarët ta bëjnë pas luftën. E kanë bërë ndërkombëtarët. Ata janë fajtorë pse kanë ndodhur, në qoftë se ka ndodhur. Në qoftë se supozojnë se kanë ndodhur pikërisht ata duhet të merren në përgjegjësi dhe të qiten para drejtësisë. Jo shqiptarët, sepse shqiptarët nuk kanë mund ta kontrollojnë veten, sepse kemi dalë nga një luftë shumë e tmerrshme.

Unë dua të ju them që mbrojeni qëndrimin se në Kosovë ka pasur luftë. Shkaqet e luftës mund t'i elaburoj këtu pse kem ardhur deri te lufta. Jo që kemi qenë trima, jo që kemi dashur vdekjen, absolut, askush s'ia dëshiron vetes vdekjen, por shkaqet e luftës dihen. Do të thotë e ka gjenezën që nga Lufta e Dytë Botërore. Dhe faktikisht lufta ka ardhur si presion dhe shtypje e vazhdueshme e jetës së shqiptarëve. Andaj, unë pajtohem me



Bylbylin kur thotë se ky komision duhet ta shtrijë aktivitetin dhe së paku të tentojë ose të bëjë përpjekje të gjejë mënyra që të hulumtojë edhe raste shumë të mëhershme se sa nga viti 1990 se ne kemi edhe vitet e 80-ta, kemi të 74-at. Vazhdimisht te shqiptarët ka pasur dhunë dhe tortura.

Prandaj, unë edhe një herë, flas në emër të organizatës dhe e mbështes këtë iniciativë dhe uroj që të kemi një bashkëpunim, të punojmë dhe t'i zbardhim këto gjëra. Unë po ua jap një lajmë shumë të hidhur, se ja që tani më erdhi informacioni se shumë kriminelë shëtisin rrugëve, një ushtar i UÇK-ës ndalohej në Kroaci me urdhër të Serbisë. Sot, pikërisht sot, vjen informacioni. Do të thotë ai djalë ka vuajtur burgun një vit në Beograd, në gjykatën për krime të rënda në Serbi dhe lirohet në mungesë të fakteve. Ai nuk mund të shëtisë ende i lirë, edhe pse është liruar. Sot arrestohet në Kroaci. Dhe, faktikisht krimineli prapë po e bën punën e vet. Akuzon njerëz që vërtet ia kanë dashur vendit të mirën, kanë luftuar dhe janë çlirimtar sot dhe atë ekzistencën e vet nuk janë të lirë ta sigurojnë.

Ju falënderoj edhe një herë dhe ju jap mbështetje dhe ju inkurajoj ju të gjithëve. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Zotëriu e kërkon fjalën, pastaj zotëri Fehrati. Vetëm prezantohuni, ju lutem!

**Halil Berisha:** Unë quhem Halil Berisha, nënkryetar i nëndegës në Malishevë të Ushtrisë çlirimtare. Ju përshëndes!

Meqë jam në kohë, për punë të nënshkrimeve desha me thënë diçka. Unë kam qenë përpara në "Ballkan" të Suharekës. I njëjti rast është përdorur atëherë puna e nënshkrimeve. Sikur ju që e thatë. I dyti rast është, që ai zotëriu e quajti luftën dhe konfliktin. Te na ka qenë luftë. Do të shkoj në pika të shkurta, e pas luftën e Perusë, mu dhimbte ai popull por te ne ka qenë ende më e vështirë, më e rrezikshme dhe më agresive. Te ne ka qenë shfarosje, atje luftë. Te ne shfarosje e një populli. Po, po kërkohej varre masive. Varre masive në Kosovë nuk ka. Ndoshta ka prej serbëve por serbët duhet me i pyetur për varre ku i kanë vendosur dhe ku i kanë lënë. Kjo shoqatë, u tha se u prek, tha që paguan parlamenti. Jo, ne shqiptarët e kemi mbajt të gjithë vetveten. Nuk kem kërkuar lëmshë, kem kërkuar drejtësi nga Evropa. Drejtësia jonë... Ne e kemi një (shesh) Sheshel në burgun e Hagës të cilit i mëvishen shumë sende, që ka bërë shumë krime ndoshta. E, nuk mund një njeri t'i bëjë krim një ushtrie, sikur që ishim ne aq të varfër, për ta mbrojtur pragun e shtëpisë ose familjen.

Kur u prek çështja e moralit, e dhunimit. Në një fshat afër nesh në Malishevë, në Belancë, janë tubuar me mijëra e mijëra. Aty ka pasur gjithçka. Unë jam njëri prej atyre që kam marrë informata në atë kohë për punë të dhunimeve, por askush traditat e shqiptarëve, i di bota fort mirë. Në mes rreshtave, që u fol, u fol për pajtim diçka. Lus shoqatat, pajtimi i shqiptarëve mund të bëhet vetëm me ua dhënë të drejtat shqiptarëve, ato që i meritojnë. Kërkimi i varrezave. Në Serbi le të kërkohej, atje janë shumë të pa zbuluara. Kurse këtu te ne, çka kemi ne i kemi dorëzuar. Kemi pasur pak diçka dhe i kemi dorëzuar. Më falni se preka vetëm disa pika të shkurtra disi.

**Besarta Vasija:** Falemnderit shumë zotëri! Zotëri Ferhat?

**Ferhat Dervish:** Unë kërkoj falje, do të flas në gjuhën boshnjake, po më duket se më mirë mund të shprehem në gjuhën boshnjake dhe për atë edhe do ta shfrytëzoj këtë gjuhë, meqë nuk po mundem në gjuhën turke.

Para së të filloj. Kështu, mua si qytetar i Kosovës gjithmonë më brengos fakti se pse erdhi deri të lufta, kush na ë imponoj këtë luftë neve. E filloj Sllovenia, e pastaj Kroacia. E kemi parë në Kroaci këtë luftë të pistë, kjo luftë nuk ishte farë luftë, ato ishin vetëm krime. Dhe lejuam që kjo të kaloj edhe në Bosnjë, i njëjti krim. Po ata të njëjtët Akrepa (Škorpioni), të njëjtët Shqiponja (Orlovi), po i njëjti Milošević'. Kur është dashur të shkatërrohet Banja Luka njerëz nga Bosnja më thoshin mua, ata të rijnë të cilët luftuan në Bosnjë, thoshin edhe dy orë na duheshin për të shkatërruar Banja Llukën, pastaj dikush tha lufta ka përfunduar, po shkojmë në Dëjton sepse nuk mund të shkatërrohet ushtria serbë në Bosnjë. Pra serbëve iu është dhënë një shtet në Bosnjë, Republika Srpska. Çfarë fituan boshnjakët - asgjë, 300.000 viktima. Në fund të luftës në Bosnjë ushtarët e NATOs, gazetarët, bashkësia ndërkombëtare, punëtorët, a e dini se çfarë i thanë njëri tjetrit? Mirupafshim në Kosovë. Kështu që këta "Škorpion" tani shkojnë të vrasin shqiptarë dhe të gjithë të tjerët në Kosovë të cilët ishin kundër Miloševićit. Si qenkan njohur këta, kush është ai që ka bërë skenar për vrasjen e këtyre njerëzve? Ne duhet ta gjejmë atë. Dhe ti kërkojmë të gjitha nga ai. Gjëja e dytë që mua më brengos. Milošević'i kishte ushtrinë ë tij të pistë, mirëpo përmes magnetofonëve, informacioneve, të cilat qarkullonin nëpër policinë e Miloševićit thuhej... kam qenë plotë 10 herë i dërguar në polici meqë në takimet më Ambasadorin Turk unë u deklarova dhe fola kundër Miloševićit, për arsye se jam turk, për arsye së jam turk, sot jam gjallë vetëm pse pas meje po qëndronte një ambasadë, dhe këtë e ka ditur Miloševići mjaft mirë. Dhjetë herë më dërguan në polici mua dhe disa shokë të mi, na përjashtuan nga puna haptazi. Neve na thanë, pranojeni, mbështetni dhe do të jetë ndryshe. Në thamë jo, nuk do ti japim Miloševićit përkrahje. Pra largohuni nga puna. Dhe pastaj u larguam nga puna. Mua më është hequr e drejta e armë mbajtjes në vitet '90, mirëpo më 1991, 92, 93, 94 disa turqve dhe disa shqiptarëve, po ashtu dhe disa boshnjakëve iu dha leja e armë mbajtjes. Ku janë këto krime? A mund të ketë sot kriminelë të tillë në Parlamentin tonë, unë e pyes shpesh vetën. Ata duhet të dënohen sepse edhe ata janë pjesë e këtyre krimeve të cilat Miloševići i kreu në këtë zonë. Dhe kush e ka mbështetur Miloševićin? Mbështetja e kujt ishte? A e mbështeti edhe populli serb? Ejani popull serb. Sot është e 2000-ta, sot populli serb është më një këmbë në Evropë, ato krime do të shkojnë në Evropë, ndërsa ne jemi akoma shumë larg Evropës, dhe ne jemi këto viktima. Njerëz, po si munden kriminelët të shkojnë në Evropë, të behën anëtarë të Evropës dhe ne nuk mundemi? Si mundën këta kriminel të shkojnë në Evropë pa viza, e në nuk mundemi? Jemi ne apo ata kriminelë? Kush e bën këtë? Kush ishte pas Miloševićit. Nëse Evropa thotë që Serbia meriton të jetë në Evropë, atëherë populli serb nuk ishte pas Miloševićit, paska qenë dikush tjetër, ata njerëz të cilët sot deklarojnë që janë popull i pastër serb. Nga ata duhet të kërkojmë, kush qëndronte pas Miloševićit. Sot shoh OËSC, Eulex, ndërsa pas Miloševićit nuk e di së kush qëndronte. Mirëpo pas nesh është Eulexi, Bashkimi Evropian, Parlamenti Evropian dhe UNMIK-u. Njerëz, unë mendoj dhe gjithmonë gjithçka mendoj... të gjitha ato trauma të fëmijëve të mi kur policia e Miloševićit më morën si një mi të bardhë të ca njerëzve. Dhe këta njerëz duhet të paguajnë për këto gjëra. Dhe pikërisht këta njerëz do të duhet të dënoheshin nga Kombet ë Bashkuara dukë dhënë arsyet e veprave të tyre. Ndërsa ne në Kosovë, në e dimë së kush janë kriminelët. E dimë kush ishte Miloševići dhe e dimë kush ishin ata njerëz, mirëpo akoma nuk kemi punuar në gjetjen e kriminelëve pa armë e me magnetofon. T'iu tregoj diçka. Kur vinte ambasadori Turk nga Beogradi në bisedime, ne ishim rreth 50-60 persona në sallë ndërsa ata vetëm 30 por ishin të pajisur më

magnetofon. Të nesërmen në mëngjes kur shkuam në polici, kur na çuan në polici, mendoja pse na dërgonin atje. Çka kam thënë, të gjitha ato që keni dëgjuar në magnetofon, iu thashë. Pra njerëz, këta kriminelë pa armatim duhet një ditë ti zbulojmë sepse ishin ata më të rrezikshmit dhe kriminelët më të mëdhenj, meqë pikërisht ata ua treguan rrugën “Škorpionvë” kush çfarë ka bërë ku. Faleminderit.

**Besarta Vasija:** Faleminderit shumë, zotëri Fehrat! Dikush tjetër? Po, urdhëroni, zotëri!

**Hysen Destani:** Jam Hysen Destani, anëtar i Kryesisë së veteranëve të luftës, dega në Prizren. Përshëndetje për të gjithë!

Ne si ish pjesëtarë të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës na ka rënë që edhe t’i përjetojmë shumë ngjarje të rënda dhe për atë edhe sot jemi tubuar këtu, andaj ju kisha uruar që kjo nismë të jetë efektive dhe të jep rezultate konkrete, sepse deri më tani jem mësuar vetëm të zhgënjehemi. Shpesh vizitojmë familjarë, që nuk e kem lehtë e të flasim edhe këtu para personave veç u takojnë familjeve të viktimave, të zhdukurve dhe jemi mësuar t’i shohim gjithnjë para kuvendit, para qeverisë, njerëz të tubuar, duke i kërkuar njerëzit e vetë dhe të cilët s’mund t’i gjejnë dot. Gjithherë ka të dhëna se ekzistojnë pjesë të trupit të tyre diku dhe asnjëherë e vërteta nuk del në shesh andaj është edhe një torturë psikike që na bëhet si popull. Ka të dhëna të sigurta se kriminelët serbë vijnë nga Serbia për t’i shitur pasuritë e tyre sepse e dinë mirë që s’kanë jetë më këtu dhe kthehen mbrapsht pa e gjetur asnjë e keqe. Ndërsa, në anën tjetër, njerëzit më të devotshëm, që tërë jetën ia kanë kushtuar çështjes kombëtare, burgosen, mbahen në burg dy-tri vite dhe lirohen si të pafajshëm pastaj. Prandaj, uroj që nga këtu, që flas edhe në emër të Kryesisë së degës në Prizren, se do të jemi për mbështetjen tuaj dhe besoj se do të dalim me rezultate konkrete. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Faleminderit shumë! Nora e kërkoi fjalën.

**Nora Ahmetaj:** Dy bashkëbisedues e përmendën punën, por edhe bashkëfolësi paraparak, lidhur me një ish-ushtar i UÇK-ës i cili është arrestuar në Kroaci. Para 3 ditësh ishim në konsultime rajonale këso lloji, por këto janë lokale dhe mbahen në të gjitha shtetet, mirëpo këto ishin konsultime rajonale dhe të njëjtat do të bëhen edhe në Kosovë, u mbajtën në Dubrovnik. Pra, u mbajtën në Dubrovnik për arsye simbolike, për arsye se Dubrovniku nuk njihet si vend ose kështjellë ku ka pasur aq luftë, gjatë luftës që ka ndodhë në mes Kroacisë, Bosnjës e Serbisë, por është sulmuar nga forcat e armatës jugosllave dhe malazeze. Aty konsultimet kanë qenë me të ish-burgosurit politikë dhe me llogarësht, llogorashë që kanë qenë nëpër llogore të Serbisë, të Bosnjës dhe Kroacisë. 6 vetë, ish të burgosur, kanë marrë pjesë prej Kosovës, kanë qenë të ftuar. Konsultimet kanë qenë konstruktive. Mirëpo, para se të mbahen konsultimet, mund të ju tregoj për shtresin që e kanë pasur organizatat joqeveritare të cilat i kanë organizuar këto konsultime me Ish-llogorashët dhe ish-luftëtarët të cilët kanë luftuar në anët e tyre, me marrë pjesë në Kroaci. Nuk e di a e keni të njohur rastin “Lora”, ata që kanë qenë të involvuar direkt luftë, si për shembull, serbët kanë kërkuar leje speciale prej Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kroacisë për të hyrë në Kroaci. E njëjta ndodhi kur kroatët ose qysh i quajnë ata – “branitelji” prej Dubrovnikut, Zarës, Vukovarit ose vendeve tjera kur shkojnë në Serbi, në Mal të Zi e në Bosnje. Pse po ndodh kjo? Ndodh për arsye se, sikur e ceka në fillim, sundimi i ligjit është i dobët ende dhe nuk ka marrëveshje ndërshtetërore as për lidhjen e statusit të ish-luftëtarëve në secilin shtet, por edhe Kroacia e Serbia po e mbajnë të drejtën që secili i kanë listat e tyre të zeza dhe secili ushtar, apo ish-ushtar që e

kalon kufirin për në vendin tjetër të burgoset automatikisht. Dhe po ju garantoj se para që të mbahet ky takim, edhe Ministria e Punëve të Brendshme, pjesëtarët serbë kanë kërkuar leje dhe garancë prej Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kroacisë se nuk do të arrestohen në momentin kur të hyjnë në Kroaci. Këtë po ua them për arsye se e di çfarë parapërgatitje paraprake janë bërë para se të shkojnë ata atje. Dhe, bisedat që i kemi pasur me organizatat aty, policët kanë qenë aty prezent. Do të thotë është kërkuar edhe një përcjellje për ta speciale.

Nuk dua të minimizoj ato burgosje që ndodhin, por njëri prej qëllimeve të komisionit është se, nëse do të ketë sukses dhe qeveritë e shkruajnë marrëveshjen ndërkombëtare se “unë zotohem që do të marrë përsipër të gjitha rekomandimet që dalin nga ky komision t’i zbatojë”. Dhe, me bindje të thellë, po qe se vijmë deri te ajo pikë, e them, në bazë të përvojave të shteteve tjera, se marrëdhëniet do të zbuten, por edhe qëllimi i komisionit është t’i shtinë shtetet me komunikuar në mes veti. Pastaj vjen edhe deri te forcimi i sundimit të ligjit, reformimi i institucioneve të sundimit të ligjit, të policisë apo të gjyqësisë dhe është sikur thonë amerikanët “vishell theking”, është një dëshirë që është diçka shumë e dëshirueshme mirëpo ne shpresojmë se nëse ka me pas sukses ky komision në një të ardhme të afërt edhe me i zbut marrëdhëniet në mes shteteve dhe normalisht me ardhur edhe te forcimi i sundimit të ligjit por edhe i reformimeve të të gjitha institucioneve dhe policisë në të gjitha këto shtete e jo me u ballafaqua me arrestime, me nënçmime, me humbje, degradime. Pra, vetëm desha ta jap një pasqyrë tjetër se këto po ndodhin edhe në shtetet si të Serbisë, Kroacisë dhe të Bosnjës. Nuk raste të sakta, por vetëm desha të tregoj rastin se si kanë ndodhur me këtë rast, çfarë përgatitje janë bërë për të pas garancë që ata pjesëtarë – ish luftëtarët nuk do të burgosen.

Tjetër koment nuk kam për këtë, por mendoj se ka mendosh kështu, për derisa nuk bëhet ndonjë marrëveshje ose nuk zbuten pak marrëdhëniet në mes shteteve.

**Besarta Vasija:** Faleminderit Nora! Unë tash ju kisha ftuar për një pauzë për drekë, e pas drekës do të kishim filluar prapë me diskutime dhe nëse i kem mbetur borxh dikujt tash, do të vazhdojmë menjëherë pas drekës. Në këtë pjesë këtej, është tryeza. Urdhëroni!

### **(Pas pauze, sesioni vazhdoi punën)**

**Besarta Vasija:** Shoh se një numër i madh veç kanë shkuar dhe më vjen keq që është kështu. Tash do të fillojmë me pjesën e dytë të diskutimeve. Nëse ka pasur dikush diçka prej herës së kaluar që ka mbet pa folë, le të urdhërojë tani. Pra, a dëshiron kush fjalën? Meqë nuk paraqitet askush, unë do të bëja pyetje për të gjithë pjesëmarrësit që janë këtu dhe të fillojmë me pyetje konkrete.

Sipas përvojave të komisioneve të tjera në vende tjera të botës, kanë ekzistuar do struktura dhe komisionet kanë qenë të ndryshme. Kjo është pyetje për ju e drejtpërdrejtë se çka mendoni ju – si do të duhej të ishte i strukturuar ky komision në qoftë se arrijmë ta themelojmë këtë.

Nga konsultimet e kaluara kemi pasur lloj-lloj rekomandime, dhe njëra prej tyre ka qenë që secili shtet të ketë zyrat e veta dhe ato zyra do të jenë në nivelin nacional ose në nivele shtetërore dhe të ekzistojë edhe një zyre qendrore e cila do ta ketë selinë diku, që për shembull shpesh kanë qenë rekomandimet të jetë në Bosnjë e Hercegovinë, pasi që atje është numri shumë më i madh i viktimave, kurse dikush ka propozuar që kjo seli kryesore të jetë në Bruksel ose diku në vende jashtë ish-Jugosllavisë e po ashtu ka pasur edhe

propozime që kjo zyre të jetë në rrotacion, për shembull një kohë të jetë në Kosovë, një kohë në Bosnjë e kështu me radhë. Mirëpo, definitivisht ka qenë kërkesë e shumicës pjesëmarrëse në konsultimet në Kosovë që kjo të mos jetë në Serbi. Do të thotë, gjithkund tjetër, përpos jo në Serbi. Ka pasur mendime që të jetë në një vend tjetër që do të jetë neutral, që nuk ka pasur lidhje me luftë.

Prandaj, ju çka mendoni, çfarë mendimesh keni, si kishte dashur të jetë kjo e strukturuar dhe po ashtu, çka mendoni si ishte dashur të vihet deri te zgjedhja e komisionarëve. Për shembull Nora tregoi se në vende të ndryshme emërimet e komisionarëve kanë qenë në mënyra të ndryshme, ka pasur do të thotë të hapura ku njerëzit mund t'i dominojnë njerëzit dhe normalisht me ato kritere që nuk do të ketë prapavijë, do të thotë të jetë i akuzuar për krime të luftës apo dikush, edhe pse nuk ka qenë i akuzuar, ka propaganduar pro luftës ose diçka tjetër.

Çka mendoni ju, cilat duhet të jenë ato kriteret për t'u zgjedh një komisionar ose edhe ku mund të jenë selitë qendrore të vendosura. Urdhëroni! Nazim Bahtiri e kërkon fjalën.

**Nazim Bahtiri:** Faleminderit! Jam Nazim Bahtiri. Vi prej Organizatës joqeveritare Jouth step nga Vushtrria. Jam anëtar i Koalicionit për KOMRA-n.

Shumë është folur ku të jetë zyra e KOMRA-s, është folur edhe prej Besartës kur tha të jetë në mënyrë rrotacioni – rrethore do të them. Unë mendoj që shumë më mirë kishte me qenë për të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë që zyra e këtij koalicioni të jetë në një vend të tretë, jashtë këtyre shteteve të ish-Jugosllavisë për arsye që mos të jetë e ndikuar nga asnjë shteti të dalë nga ky shtet i ish-Jugosllavisë. Pra, mendoj se më e mira prej të gjithave kishte me qenë që zyra e KOMRA-s mos të jetë në rrotacion, por të jetë në një vend, në cilin vend do të mund të kinin qasje të gjitha shtetet që kanë dalë prej ish-Jugosllavisë. Po, të marrim shembull, do të ishte mirë të jetë edhe në Slloveni dhe të jetë e pranueshme nga të gjitha shtetet që të jetë zyra e KOMRA-s, po prapë se prapë meqë ne sot jem këtu mund të shprehim edhe mendime tjera për atë se ku do të mund të vendoset zyra e KOMRA-s. Pra, për këtë do të ishte mirë të diskutojmë sot.

Unë jam i mendimit se kishte me qenë mirë që zyra e KOMRA-s të jetë në Slloveni, një vend pra i tretë jashtë vendeve të ish-Jugosllavisë. Dihet se edhe Sllovenia ka dalë prej ish-Jugosllavisë mirëpo ka dalë pak më herët dhe ka krijuar një stabilitet paqësor, të them kështu, nga vendet e ish-Jugosllavisë. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Faleminderit, Nazim! Urdhëroni, zotëri!

**Ejup Kabashi:** Ndoshta s'ka nevojë të prezantohem përsëri?

**Besarta Vasija:** Ka nevojë, për shkak të transkriptimit!

**Ejup Kabashi:** Atëherë, jam Ejup Kabashi, kryetar i Organizatës së veteranëve të luftës. Unë nuk e ndaj mendimin që zyra të jetë në Slloveni, për arsye se në vitet e 80-ta a 90-ta pjesëmarrëse e shtypjes së demonstratave në Kosovë kanë qenë edhe policët sllovenë, kroatë e boshnjakë, ku ta di unë. Nuk e ndaj pra mendimin e tillë. Jam i mendimit që të jetë në një vend ku bëhet trusni pranë parlamenteve dhe gjithmonë politikat ndërkombëtare frekuentojnë më shumë, prandaj pse të mos jetë në Bruksel apo diku tjetër, por jo në shtetet e ish-Jugosllavisë. Pra, mendimi im është i këtyllë, e tash ju mund të keni mendime tjera. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Urdhëroni!

**Bujar Ukimeri:** Desha edhe unë të propozoj. Jam Bujar Ukimeri, anëtar i Shoqatës së invalidëve të luftës. Pati shumë për të biseduar por i dhanë shumica mendimet e veta dhe sigurisht se është herë e parë, nuk do të hapemi shumë dhe ju urojmë sukses. Kjo është

dashur ndoshta edhe më herët por nuk është keq edhe vonë. Po a dini, si është një proverb popullore që thotë “Ujku ia turbullonte qengjit ujin”. Unë po frikësohem nga kjo. Vërtetë është dëshira, jo për me frikësuar dikë, se jem shumë të interesuar ne dhe çdokush që është viktimizuar të realizohet kjo. Makar nëse edhe unë jam që i kam bërë dikujt diçka, le të përgjigjem, por kur e shoh vërtet se ne shqiptarët më së shumti e kemi paguar këtë. Çdo lloj periudhe, që e tha edhe Bylbyli, atëherë i lamë ato. Po edhe këtë të fundit e kemi për të njëjtën gjë. Ai që është kriminel ai është më viktimë se ne se as nuk ndien për ne, as për botën e sende. Çka është e keqja më e madhe, atyre u bëhen konsesion, u ofrohet me hy në NATO e në Evropë dhe neve na qiten standarde e mbi standarde, pesë herë – dhjetë herë standarde. Ajo botë që kërkon drejtësi dhe që i afron ligjet për të drejtat e njeriut dhe për të gjitha standardet, është brenda dhe fare neve na mban në një lloj rezervati si indianë, thjeshtë në rrethim, dhe krejt këto shtete përreth i pranon në Evropë e ku mos, kurse neve na lyp standarde dhe në fakt ne nuk na lë asgjë. Do të thotë gjithmonë ne jemi shumë liberalë dhe gjithçka kërkojmë e gjithçka lejojmë, gjithçka pranojmë po edhe më të keqen, por në fakt ne nuk na jepen mundësitë. Është një frikë se do të realizohet kjo. Është një frikë e madhe, jo pse e tha edhe Bylbyli në fillim por po e them edhe unë këtë. Ka shumë për t’u diskutuar, por këtu janë dy rrafshet e problemeve më të mëdha: një është ajo që nuk është bërë, për shembull sikur në Afrikën e Jugut që u bënë disa krahasime, është krejt një tretman, është vetëm një unazë që na lidhë, një regjim me një numër të caktuar të vogël të njerëzve që e ka mbajtur pushtetin në Afrikën e Jugut me sa milionë njerëz, sikur që kemi pas Serbinë me një grup njerëzish e ka mbajtur pushtetin në Kosovë dhe ka bërë kërrdi, gjenocid e ku ta di unë çka. Dallimi është se ata kanë qenë vendas dhe kanë ndej aty, janë gjykuar dhe kanë bërë atë baraspeshën para viktimës dhe ka kërkuar falje e tjera. Te ne nuk qëndron kurrë ajo për shkak se ata kanë djegë, kanë pre e kanë masakruar dhe tokë të djegur e ka lënë dhe ka ikur në Serbi dhe nuk ka gjasa kurrë ne të ballafaqohemi me ta.

E dyta. Unë dëgjova për shembull për 11 raste kur kanë qenë në Tribunal të Hagës. (reagim)

Mirë, për Kosovë, por ta zëmë dhe të marrim shembull. Ne e dimë mirë se çfarë struktura i kanë bërë këto. Këtu ka qenë një armatë e tërë. Së pari është marrë me ofensiva të llojllojshme dhe është marrë me 200.000 ushtarakë, po edhe paramilitarët, ato “shqiptonjat e bardha” – “Beli orao” që i kanë quajtur, në desh “Tigrat e Arkanit”, në daç “Beretat e kuqe” që unë personalisht i di se kam qenë pjesëtarë i luftës dhe kam qenë i plagosur prej tyre, e di mirë atë punë, po ato janë çështje ushtarake, ne flasim tash për civil dhe është fjala për viktimat dhe sot askush nuk i jep kërkuat llogari. Unë pra e kam një rezervë se do të ndodhë, e ishalla kjo në një të ardhme do të bëhet.

Kurse sa i përket ku të jenë zyrat, mirë e tha edhe Ejupi, do të thotë atje nuk është mirë të jetë ku është përdorur dhuna, në emër të shteteve të ish-Jugosllavisë, edhe sllovenët e kanë përdorur atë, kanë shtypur demonstratat dhe kanë marrë nga 10 – 12 vjet burgje për një fjalë goje për një KR e kurrëgjë hiq, kështu që mirë do të ishte të jetë në një vend të tretë ku mund të bëhet trysni.

Faktikisht, për ne shqiptarët ka filluar të kanë një frikë që edhe ata ndërkombëtarët janë duke luajtur me standarde jo të dyfishta por të dhjetëfishta me ne, për shkak se edhe ata nuk po bëjnë kurrfarë trysnie në asnjë aspekt.

Ne kërkojmë dhe pranojmë gjithçka ose çdo lloj standardi të futet dhe t’u tregojmë se ne jemi popull që e domi lirinë, kurse ata u ofrohen atyre që bëjnë krime dhe u thotë: hajde

në Evropë të lutem. Mos duhet edhe na t'i themi se nuk domi ne Evropën me pa, dilni lëshone Kosovën e ata ndoshta na lusin neve – hajdeni në Evropë ju. Jo, kjo na ka ardhë të themi – dilni lëshone Kosovën e na leni ne në këtë fukarallëkun tonë, e ndoshta këta thonë hajde se po duheni. Sepse, kështu po ndodhë. Se t'i marrësh 350.000 viktima në Bosnjë, të marrësh diku 17 – 18.000 në Kosovë dhe në Kroaci që janë nuk di sa mijë, është shumë e çuditshme pse ndaj ne bëhet e veçantë diçka.

Një tjetër që është, ne kemi standarde për minoritete dhe formojmë çka nuk ka ndodhur askund në botë. Shumë diçka që as shtetet në botë si shtete demokratike që kërkojnë të drejtat, te ne bëhen eksperimente të llojllojshme, standarde që kurrnjëherë në asnjë vend nuk janë përdorur, e këtu po përdoren. Mirë, nuk jemi ne kundër asaj. Por, a bëjnë standarde për këta njerëz që kanë bërë krime dhe janë këtu brenda, që tha ai zotëria aty, që tha me armë a pa armë, unë e dëgjova mirë dhe që i kemi ne në Gore njerëzit që marrin rroga të majme prej Serbisë, që na sfidojnë ne, Kushtetutën e Kosovës dhe shtetin e Kosovës dhe thonë në emër të minoriteteve të gjitha standardet i bëjmë për ta kurse ata neve gjithmonë na bëjnë rezistenca, na sfidojnë. Qe, për shembull në fshatrat e Gorës kemi qak që bëjnë thirrje mos me dalë në zgjedhje as kurrgjë dhe i marrin rrogat nga 800 euro prej Serbisë i marrin rrogat edhe nga shteti i Kosovës dhe për ta, më mirë që sot unë si vendas, si patriot i këtij vendi, shumë herë mendoj dhe shpirtnisht po them, jo për diçka tjetër, më mirë qenka me qenë minoritet se çka po deshte të bësh po mundshe të bëjsh, se me qenë shumicë.

Kur ishte koha e shumicës u shkelke prej asaj pakice, e tash prapë prej asaj pakice shkelet prapë shumica. Veç një formë tjetër është ndërrua. Do me thënë, ne nuk po kemi kurrfarë të drejte. Pse s'merrem ne me këtë. Ne kem jo sall këto strukturat paralele në Mitrovicë të veriut, ne i afrojmë edhe decentralizim, gjithçka. Në emër të asaj drejtësie, barazie që ne e dimë në lëkurë sa e kemi paguar dhe e dimë çka është me të shkelë dikush, por pse ndonjëherë nuk ndalet dikush me thënë ju çka po boni – gjithçka shqiptarët po pranojnë, po ju edhe po i shfrytëzoni edhe po i keni të gjitha të drejtat dhe prapë po e sulmoni këtë vend. Kjo është frika më e madhe që ne dyshojmë se do të realizohet ndonjëherë, ose ndoshta në një të ardhme do të bëhet por për momentin jemi shumë skeptikë që të realizohet.

Ne ju dëshirojmë fat vërtet dhe do ta keni përkrahjen, por ju them një – nëse doni me fillua të bëni diçka filloni prej baze, mos të thirremi në atë në emër të popullit, sikur deputetët – në emër të popullit dhe kurrë për popullin s'punojnë, por nisuni prej bazës se në qoftë se unë jam prej familjes së viktimizuar, më mirë familja ime ta tregon se ti që e din atje në Prishtinë që të ka emëruar e që nuk ke lidhje me veprat dhe me krimet e as me kurrgjë. Mirë është të fillohet prej baze, edhe prej gjinive. Nëse në familjen time ka ndodh një dhunim, edhe në qofsha burrë, që i ndodhë edhe vajzës sime, motrës time apo nënës time, nuk mundet më mirë se nëna ime ta tregojë askush të vërtetën. Mirëpo, kush mund t'i afrohet asaj si femër që ka halle, jo unë si mashkull. A e keni parasysht? Kjo ishte! Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Absolutisht! Faleminderit zotëri Bujar! Unë plotësisht pajtohem me krejt këto që i thatë dhe mendoj se edhe kjo është për shembull një rekomandim shumë i mirë kur femrave hulumtues duhet afruar si femra sepse nuk mundet një mashkull të dërgohet te një femër që është e dhunuar. Prandaj, duke marrë parasysht edhe mentalitetin tonë që kemi, duke marrë parasysht ndoshta edhe religjionin parasysht jo vetëm te myslimanët por edhe te religjionet tjera, sa e vështirë është për t'iu qasur një femre e cila është e dhunuar.

Prandaj ne po i marrim këto rekomandime prej jush se cila është mënyra më e mirë sepse ju jeni ata të cilët e keni ndie në lëkurë dhe ne nuk po domi të shkojmë nëpër qeveri sikur që kanë ndodhur nga komisionet tjera dhe kanë dështuar, por po domi të shkojmë në bazë të njerëzve të cilët e kanë pa dhe përjetuar në lëkurën e tyre. Më mirë se ju që keni qenë i plagosur, nuk mund të tregojë diçka. Pra, mua nuk mund të më tregojë dikush qysh jeni plagosur ju, se sa vetë ju të tregoni. Prandaj, ne na duhen këto dëshmi dhe ne po domi të shkojmë me këso qasje te secili individ, te secili njeri që ka qenë viktimë ose të paktën që ka qenë edhe dëshmitarë okular. Edhe te ne ekziston frikë e madhe se a ka me pas sukses a jo. Nuk është vetëm te pjesëmarrësit. Edhe ne kemi frikë se ku do të arrijmë me këtë.

Prandaj, për këtë ne po e bëjmë këtë iniciativë, pra ne – shoqëria civile. Sepse, deri sot nuk e ka bërë qeveria as e Serbisë, as e Kosovës, as e Kroacisë dhe asnjëra. Prandaj edhe u pa nevoja që ta bëjmë një iniciativë të tillë pikërisht nga shoqëria civile dhe kur ne në njëfarë mënyre jemi opozitë e qeverive dhe jemi aty për t'i kritikuar ose me u treguar se çka është dashur të bëhet atëherë kur ata nuk i kryejnë detyrat e tyre. Nuk është lehtë të kemi këtu njerëz të cilët kanë qenë të shtypur gjatë luftës dhe para luftës dhe në fund prapë të mos merret parasysh ajo që keni përjetuar ju. Pra, ne po domi ta ndërprejmë këtë fatkeqësi, ta quaj ashtu dhe po kërkojmë prej jush dhe po ju lus sinqerisht të gjithëve të involvohen më shumë në debat dhe secili të shpreh mendimin e vet.

Këtu ne e kemi edhe një psikolog, i cili më së miri di të na tregojë për përvojat e tij dhe mund të na tregojë se si mundemi ne t'u qasemi viktimave, qofshin ish të burgosurit me të cilët punon vetë zotëriu këtu, qoftë me femrat që është edhe rekomandimi jua se një femër duhet me iu qasur, apo se a duhet me pas ne edhe hulumtues prej Prizreni i cili do t'i hulumtojë rastet në Prizren për shkak se megjithëkëtë është njëfarë dallimi në mes rajonit dhe rajonit tjetër, dhe ndoshta është më lehtë me i bë intervistimet dikush nga ai vend apo dikush me ardhë nga Prishtina. Do të thotë këto janë shumë gjëra të rëndësishme që ndoshta në fillim duken gjëra të vogla por në fakt janë shumë të rëndësishme për ndikimin dhe efektin psikologjik te vetë viktimat. Zotëri Aqif?

**Aqif Ilazi:** Përshëndetje, të gjithëve edhe një herë. Jam Aqif Ilazi. Jam përfaqësues këtu i Shoqatës së të burgosurve politik, dega në Prizren.

Meqë në njëfarë forme më detyruat të marr fjalën, po e marr. Do të ndërlidhem pikërisht te aspekti psikologjik i përjetimit të gjërave të ndryshme, katrahurave të mëdha që i ka përjetuar populli ynë.

Do të doja të shpjegoj në pika të shkurtra diçka vetëm për stresin. Në tri mënyra përjetohet stresi, ose fitohet stresi - stresi negativ e kam fjalën, sepse është edhe një stres tjetër pozitiv. Stresi përfitohet duke qenë vetë spektator, duke qenë spektator dhe parë një gjendje se si ndodh. Janë dy më të lehta, po i përmendi për me u kthye në fund te ajo që është më primare. Stresi përjetohet duke qenë edhe vetëm dëgjues, duke i dëgjuar rrëfimet e tjerëve dhe përfitohet edhe në atë mënyrë stresi – trauma. Ajo që është më e rëndësishme dhe që ka ndodhur po thuaj te i gjithë populli shqiptar se populli shqiptar ka qenë i përfshirë drejtpërdrejtë me tortura, në trauma të ndryshme. Do të thotë vetë ka qenë i përfshirë, në shumicën e rasteve ka qenë edhe spektator edhe dëgjues por ajo çka është më e rëndësishme ka qenë drejtpërdrejt i përfshirë.

Sa është e rëndësishme kjo për ne në përgjithësi, po edhe ky komision, kjo iniciativë, për shkak të shumë dyshimeve të mia dhe po i lë anash ato që u diskutuan me udhëheqësen apo panelistën këtu. Mirëpo, megjithatë është e rëndësishme që ka filluar diçka të ecë në



këtë drejtim. Ajo që është shumë e rëndësishme, është se duhet punuar jashtëzakonisht shumë me njerëzit që i kanë përjetuar këto gjëra por në mënyrë profesionale.

Unë do t'ua tregoj vetëm një shembull. Kur kam dal prej burgu, kam shkua menjëherë pas dy muajve pa proces rehabilitimi, pa asgjë, kam shkuar në studime. Në mesin e shokëve, njerëzve që kanë qenë studentë edhe ata, po që nuk i kanë përjetuar këto gjëra më kanë bërë pyetje shumë interesante. Ndoshta mund t'i duket dikujt banale, por është gjë që më ka ndodhur mua. Njëra prej pyetjeve ka qenë, në fillim po e bëj një digresion të vogël, thotë: sa vjeçar keni qenë kur kam qenë i burgosur unë para dhjetë viteve. Dhe, një prej kolegëve më pyet, a ka pasur femra në burg. Paramendoni çfarë përjeton dikush që i ka përjetuar këto gjëra, do të thotë. Ajo merret në mënyrë qesharake, ai bën shaka, janë studentë të gjithë, dhe bën shaka. Si e kam përjetuar unë? Po disa tjerë, duke pasur parasysh se unë kam qenë student i psikologjisë, po personat tjerë që janë të burgosur, që e kanë përjetuar masakrën e Dubravës, siç e kemi përjetuar ne personat tjerë që i kanë parë anëtarët e familjes së vet duke u vra, duke u malltretuar ose që i kanë ndarë prej rreshtit, siç më kanë treguar. Si e përjetojnë ata një qasje të tillë? Do të thotë duhet të jetë shumë profesionale, duhet të jetë shumë e butë, duhet të gjendet momentin shumë i saktë. Pajtohem plotësisht me atë që e tha zoti Bujari – se duhet të jetë i gjetur njeriu adekuat, situata adekuate dhe të gjendet momenti i duhur kur bëhet ajo qasje dhe si të bëhet ajo qasje, në mënyrë profesionale.

Po kthehem tash, për të mos e zgjat, se sigurisht do të implikohem përsëri në bisedë. Kush duhet të jetë komisionar, më duket kështu ishte pyetja. Unë mendoj se do të ishte mirë që të jetë dikush që ka qenë i përfshirë në këto situata, sepse ai mund të jetë treguesi ose përfaqësuesi më i dinjitetshëm i gjithë kësaj iniciative. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Faleminderit shumë zoti Aqif! Urdhëroni, zotëri Qerim!

**Qerim Bajrami:** Përshëndetje për të gjithë! Përndryshe jam anëtar i Këshillit konsultativ për komunitete në Kosovë.

Unë jam C'elim Bajrami, nga Organizata Joqeveritare Selam, përndryshe anëtarë i Këshillit Konsultativ të Komuniteteve në Kosovë, nga komuniteti boshnjak . Këtu u thanë shumë gjëra, disa njerëz kanë shkuar, dua vetëm të shfrytëzoj rastin të them që formimi i këtij komisioni është jashtëzakonisht domethënës për Kosovën dhe për të gjithë regjionin. Gjithashtu këtu u thanë disa gjëra të cilat unë dua ti tërheq. Naim, ky komision që do të formohet dhe që do të punoj në nivel të Kosovës, nuk dyshoj që do të punoj më së miri për Kosovën. Nëse puna e këtij komisioni do të rezultoi me zbardhjen e fatit të ndonjërit nga të zhdukurit, ndoshta krijimi i tij do të jetë i justifikueshëm. Zbulimi i një të zhdukuri për familjen do të thotë shumë. Nëse gjithashtu puna e këtij komisioni do të rezultoi me gjetjen e një kriminelit natyrisht që formimi i tij do të jetë i justifikueshëm. Mirëpo unë mendoj që këtu e rëndësishme është të ilustrohen, këto që kam dëgjuar nga zotëriu i ri Bylbyl dhe nga njerëz të tjerë, diçka ka shtuar edhe z. Dudak nëse nuk gaboj, ky komision sikurse Komisioni i Bosnjës dhe Hercegovinës shpresoj që ata sigurisht e dinë që duhet të mbajnë llogari për një tendencë e cila është e pranishme edhe në komunitetin ndërkombëtar dhe në Ballkan, në mënyrë që karakteri i konfliktit dhe acarimi i luftës në Ballkan të përumbet. Kjo është tendencë përbrenda komunitetit ndërkombëtarë që shkaqet e luftës të injorohen. Për këtë gjë u bisedua sot këtu. Nëse llogariten gabimet individuale, natyrisht që ekzistojnë individë të cilët kanë bërë gabime të caktuara. Unë do të jem shumë i hapur, në Kosovë nuk duhet të ekzistojë turpi pse ekzistojnë individë

kriminel, dhe gjithashtu as komuniteti shqiptar nuk duhet të turpërohet për këtë fakt dhe ti fsheh kriminelët e tillë. Nuk ka Kosova çfarë të fsheh. Ekzistojnë individ kriminel dhe në interes të Kosovës është që këta njerëz të zbulohen. Mirëpo në nuk duhet të heqim dorë, as boshnjakët në Bosnjë nuk duhet të heqin dorë në asnjë mënyrë nga kjo marrëveshje, dhe cilat janë arsyt kryesore të luftës, dhe nuk ka qenë luftë, luftë kishte në Kosovë, I emëruar si agresion shtetëror I Beogradit mirëpo në Bosnjë dhe Hercegovinë është kryer agresion. Ata sot thonë që ishte një luftë qytetare. Boshnjakët në Bosnjë nuk deshën të luftonin me letër dhe laps, të luftojnë kundër mijëra tankeve dhe topave. Për këtë arsye dikush ka kryer agresion dhe sot ky person të cilin e ka paguar Shtabi Gjeneral I Beogradit ecë lirshëm nëpër Serbi, 15 vite pas gjenocidit në Srebrenicë, Ratko Mladic. Ndërsa njerëzit të cilët kanë therë zyrtarisht, ndoshta mund të këtë edhe më shumë viktima në Srebrenicë sot, mirë tha z. Delic', lirisht mund të shkoj në Bruksel dhe vende të tjera të Evropës, ndërsa njerëzit të cilët kanë mbijetuar rastësisht gjenocidin në Srebrenicë e të cilët kanë familjarë në Sarajevë apo në Tuzëll nuk mund ti vizitojnë të tjerët të cilët janë të zhvendosur në Evropë. Ky është fakt dhe ne si kosovarë, si njerëz, si shqiptarë, si boshnjak, sikurse të gjithë njerëzit që I dëshirojnë më të mirën këtij vendi duhet ta tregojmë hapur që në jemi evropian dhe nuk kemi çfarë fshehim nga Evropa, mirëpo na vjen shumë inat kur të gjitha këto ne nuk I gëzojmë madje I kemi të ndaluara. Edhe diçka dua të ndaj më ju, dhe shkurtimisht, prapë se prapë ulëset e Komisionit Qendror le të jenë diku në Evropë, ndoshta në Bruksel, vetëm mos të jenë në hapësirat e qendrave ish Jugosllave, dhe në asnjë mënyrë të mos jenë në Beograd. I dëshiroj edhe njëherë sukses këtij komisioni dhe dëshiroj që kjo pjesë të cilën e kam përmendur e që realisht ishte temë e mëparshme diskutimi, asnjëherë të injorohet nga anëtarët e komisionit sepse kjo tendencë e sektorit joqeveritar të Beogradit dhe të gjitha institucioneve është që faktet e luftës të ndryshohen për historinë e shkruar, ky është çelësi. Ndërsa ne duhet të insistojmë gjithmonë në zbulimin e atyre që ishin kandidat dhe kryes të krimeve për hir të historisë, edhe për gjykatat, për të ardhmen, në mënyrë që të thuhet qartë dhe zëshëm kush ishin kryesit kryesor të krimeve, krimeve institucionale, krimeve shtetërore në Ballkan. Por jo krimet e individëve. Ajo është shumë e rëndësishme dhe nëse do të ishte realizuar, mendoj që kam kuptuar, jashtëzakonisht e rëndësishme është që njerëzit të cilët u bënë viktima të luftës, të cilët kanë persona të zhdukur, të jenë rregullisht të kyçur në punën e këtij komisioni. Edhe diçka. Mendoj që kam parë një gjë shumë të rëndësishme diku gjatë materialit, që njëri nga mandatet e këtij komisioni të jetë në bazë të të gjitha pikave pozitive që përfshijnë edhe pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore në planifikimin dhe ekzekutimin e krimeve. Kjo është qenësore. Do të thotë që ky mandat I këtij komisioni, veçanërisht I Komisionit në Kosovë nuk duhet të jetë I lënë pas dorë. Faleminderit.

**Besarta Vasija:** Faleminerit shumë, zotëri Qerim! Dikush tjetër? A dëshiron të marrë fjalën dikush tjetër? Po, edhe vëzhguesit mund ta marrin fjalën, nëse kanë diçka për të thënë.

**Vildane Minci:** Duke qenë se jemi vëzhgues në këtë konsultim, në këtë debat, le të konsiderohet edhe kështu – si koment i një pale vëzhguese. Jam Vildane Minci, nga Caritasi zviceran.

E përmendët, ndoshta mundësinë e vështirësive rreth financimit të punës së këtij komisioni, duke pasur parasysh çfarë është koordinimi me komisione tjera që veprojnë

në këtë fushë. E dimë se ka komisione në Kosovë po edhe në shtete tjera të rajonit që veprojnë për çështje të ndryshme dhe janë të lidhura me viktimat, me të zhdukurit e tjera. Si është koordinimi ose si e mendoni koordinimin e punës tuaj me këto komisione tjera, ose të paktën a keni menduar për këmbimin e informatave në bazë të shënimeve me këto komisione tjera në mënyrë që të paktën ajo punë të bëhet dhe ajo punë fillestare të mos dyfishohet ose shumëfishohet. Kaq për fillim, ndoshta më vonë paraqitem prapë.

**Nora Ahmetaj:** Kur thatë – komisione a menduat në komisione qeveritare për persona të zhdukur apo menduat në organizatat dhe asociacionet e viktimave dhe të familjarëve të personave të zhdukur apo asociacionet e ndryshme.

(Ndërprerje e incizimit)

**Besarta Vasija:** Ne ende nuk jemi komision!

Vildane Minci: (flet me pengesa, nuk dëgjohet për transkriptim – Besarta mund ta formulojë pyetjen e saj)

**Nora Ahmetaj:** Po, po – e kuptova. E di për çka, por desha të sigurohem. Ky komision është iniciativë – koalicion për t'u formuar komision rajonal. Normalisht se do të jetë krejt i pavarur dhe jashtë ndikimit të secilës qeveri deri në momentin kur i dorëzohet parlamenteve për shqyrtim, debatim dhe pastaj aprovohen prej qeverive. Në momentin kur qeveritë ose parlamentet e pranojnë që një komision i tillë legjitimohet si formim i një komisioni, të dhënat e para, nëse fillon me punua komisioni, baza e parë e të dhënave do të jetë Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Ata i kanë të dhënat më relevante për personat e zhdukur. T'i marrim vetëm personat e zhdukur, nuk po marrim shembull shkelje të drejtave të konventave apo të drejtave të njeriut, pastaj merren për bazë organizatat relevante lokale të cilat kanë një bagazh përvojë për mbledhjen e fakteve kundër shkeljes së të drejtave të njeriut dhe merren nën konsulentë me organizatat ndërkombëtare dhe nga përvoja ose ekspertiza e tyre. Kur të merren dëshmitë, komisioni do të punojë i pavarur dhe do t'i thërret edhe një herë dëshmitarët të dëshmojnë, por bazë për t'i hyrë për të bërë një plan strategjik se si të fillojnë dëshmitë do të jetë së pari Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, së paku është përvojë edhe e shteteve tjera dhe pastaj merren për bazë edhe informatat tjera rajonale, pastaj merren edhe informata prej komisioneve shtetërore për personat e zhdukur sepse këto anë të ndërlidhura dhe njëra pa tjetrën nuk mund të punojnë e as të operojnë. Kur pyetët lidhur me financat, pyetja ishte....

**Vildane Minci:** Financimin e lidha me këtë çështjen e koordinimit të informatave ose të këmbimit të informatave me komisione të ndryshme dhe kjo ishte... Do të thotë mjaft mjete mund të kursehen nëse nuk bëhet punë e dyfishtë apo e shumëfishtë. Kjo ishte ajo. Do të thotë ishte për fillim të punës së komisionit, në mënyrë shumë të pavarur dhe besoj se do të jetë punë e pavarur e komisionit, por të paktën të shfrytëzohen disa resurse që veç ekzistojnë, kudoqofshin ato.

**Nora Ahmetaj:** Resurset do të jenë ato resurse që ekzistojnë si bazë. Mirëpo, edhe një herë kur të thirret dëshmitari për shkak të natyrës së pavarur të komisionit duhet patjetër... Mirëpo nuk do të thotë se krejt të dhënat që i ka Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe të dhënat që i kanë organizatat të gjitha të hyjnë në mandat të komisionit. Kanë me hyrë për shembull shkeljet specifike të të drejtave të njeriut dhe thirren dëshmitarët okularë për ato shkelje specifike. Sepse, gjykatat nuk munden të gjitha rastet e krimeve të luftës t'i përfundojnë. Këtu u muar edhe kohëzgjatja prej viteve të 70-ta, e të 80-ta. Nëse fillon në atë mënyrë ose nëse mandati i komisionit do të përmbledhë një periudhë historike të gjatë të gjithë rajonit, unë nuk besoj se mund ta përfundojë atë punë. Ta marrim një shembull,

sikur është Uganda, një shtet në Afrikën perëndimore, e ka formuar komisionin për të drejtat e njeriut, i cili herë mbyllet e herë hapet, pavarësisht mjeteve të cilat i marrin prej qeverisë nga se nuk kanë mjete. Pra, pra pa marrë parasysh se komisionarët i ka pas të mirë, për 9 vite ai komision nuk ka mund ta përfundojë punën për mungesë të mjeteve financiare, ngase nuk kanë mund të marrin mjete prej shteteve tjera ose institucioneve ndërkombëtare, kurse shteti i vet apo qeveria nuk kanë pas buxhet t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet. Prandaj, nuk mundemi ta anashkalojmë çështjen e financimit të komisioneve, sepse varet nga vet puna dhe motivimi për punën e komisionarëve dhe për hulumtimin e shkeljeve të drejtave.

**Vildane Minci:** Është e qartë se intervistimet do të përsëriten dhe puna në terren do të përsëritet, por të paktën të mos shkohet në identifikim të viktimave edhe një herë prej fillimit. Për këtë ishte ajo pika që desha ta vë theksin. Për kohëzgjatjen.

**Besarta Vasija:** Faleminderit shumë!

**Vildane Minci:** Jo, pasi e morra fjalën, do të vazhdoj! Rreth periudhës e cila duhet të përfshirë në punën e këtij komisioni, për rrethana të Kosovës mendoj se të paktën viti ose vetë heqja e autonomisë së Kosovës duhet të jetë periudha prej ku duhet filluar këto hulumtime. Pra, prej viteve 87, 89 – debatet e para për heqje të..., ajo është koha më domethënëse. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Faleminderit! Urdhëroni kush dëshiron të marrë fjalën?

**Bujar Ukimeraj:** Desha të kuçem. Mua më intereson si qëndron disponimi nga shteti serb. Për qeverinë nuk po flas se dihet për qeverinë e tyre, por nga njerëzit që kanë të drejtat e njeriut, zakonisht sikur që është një Natasha Kandiç e Biserka, nëse s'gabohej është Biserka, si qëndron te ata disponimi për këtë punë për t'u kyçur sepse unë mendoj pa hanxhi s'bëhet pazar, a po dini. E kam fjalën ne pa ta vetëm sillemi rrotull e rrotull dhe pa ta mbyllen të gjitha rrugët dhe u krye muhabeti. Prandaj, mua më intereson çfarë është qëndrimi i tyre, a janë të interesuar për të njëjtën gjë, për të njëjtën iniciativë që ju do ta bëni e vazhdon. Sepse, unë po them, të gjithë kemi dëshirë, por kur vjen fundja – finalja, mbyllen rrugët dhe merr fund. Për këtë a keni ndonjë përgjigje të më jepni?

**Nora Ahmetaj:** Ju zotëri po prekni bash aty, në nerv! Inicues të kësaj ideje për formimin e këtij komisioni, thamë se ka ardhur prej shoqërisë civile dhe është pikërisht Fondi për të Drejtën Humantare - Natasha Kandiç, është Dokumenta nga Zagrebi dhe është Qendra për Hulumtime dhe Dokumentim nga Sarajevo.

Në bazë të informatave që i kam, për shkak se shpesh po na bie të udhëtojmë në rajon për konsultime rajonale, shoqëria civile e Serbisë është treguar e gatshme dhe edhe ata kanë shprehur përgjigje shumë pozitive prej shoqërisë civile dhe instancave të ndryshme lidhur me zbardhjen e krimeve të luftës dhe sidomos pjesëtarët e ri të shoqërisë civile në Serbi janë shumë të interesuar ta dinë çka ka ndodhur në të kaluarën. Mirëpo, edhe atje është një pjesë – veteranët e luftës dhe shoqatat e familjarëve të zhdukur dhe veteranët e luftës, hezitojnë dhe me skepticizëm e presin këtë ide dhe i kanë arsyet e veta, kanë frikën e vet, i kanë familjarët e zhdukur dhe familjarët e veteranëve jo vetëm këtu në rajon por edhe në vende tjera dhe përvoja tregon se gjithmonë e kanë atë aspektin psikologjik, frikat se çka do të na sjell ky komision dhe a mos t'i nënshtrohemi edhe një herë një maltretimi tjetër, apo ndonjë thyerje, pastaj frikat që i kanë edhe në shoqëritë civile edhe në Kroaci, e në Bosnje sidomos nga se ajo çka ka ndodhur në Bosnje, dorën në zemër, aty është boshti dhe nëse ky komision të ketë apo jo sukses – boshtin e ka mu në Bosnje nga se aty ende implikime, aty janë tri shtete, jo vetëm Bosnja e Serbia por edhe Kroacia.

Desha edhe diçka tjetër, pyetja juaj e dytë ishte lidhur me...?

**Bujar Ukimeraj:** Thash si është disponimi i këtyre njerëzve në Serbi? Ishte fjala për këta njerëz – aktivistë por edhe tjerë për këtë çështje. Për këtë unë e lidha se ishte puna e veteranëve, se më pas ra rasti me një veteran të Serbisë, tha edhe ti edhe unë jemi veteranë, unë kam ardhur me ta marrë Kosovën e ti me mbrojt. Dolëm dy veteranë, ai pak më ndryshe me mua.

**Nora Ahmetaj:** Sa i përket Qeverisë së Serbisë, shoqëria civile sidomos organizatat për të drejtat e njeriut në Serbi sa e di nuk kanë edhe shumë reiting të mirë dhe nuk janë shumë mirë të pranueshëm por prej kuriozitetit kohëve të fundit unë i kam përcjell nja dy-tri deklarata të presidentit të Serbisë Tadiq i cili në fjalimet e tij e ka përmendur dy herë fjalën – pomirenje – pajtim dhe së fundi e ka pas edhe një propozim për ta futur për aprovim rezolutën për krimet në Srebrenicë në Parlamentin serb. Këto janë gjëra të cilat edhe kur i lexojmë na kalojnë shkarazi mirëpo nëse pak lexojmë midis rreshtave, dhe se a bëjnë nën presion apo jashtë presionit nuk e di, por shohim se ka disa lëvizje të cilat nuk janë për mos me i prit ashtu dhe të shohim realitetin çka po na tregon por ai i ka përmendur këtë, kurse liderët...

**Bujar Ukimeraj:** Po, ai e ka përmendur atë për falje në Srebrenicë, u ka thënë boshnjakëve, dhe thotë atë në Parlament. Por në tjetrën anë, ujku kimen s'e ndërron, do të thotë e ndërron por zanatin jo, sepse atje tash po lufton në Bosnjë me heq Srpska krahina – a republika me u nda. Shumë ata janë të mençur për politikë por unë po flas për të drejtat e njeriut se për politikë të serbëve veç jemi mësuar fort prej tyre.

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni!

Ferhat Dervish: Vetëm edhe diçka. Duhet të shihni edhe diçka tjetër, nëse një numër I konsiderueshëm I individëve janë shpërngulur në Serbi. Edhe sot Sandžaku vazhdon të jetë problematik për Serbinë dhe Ballkanin. Çfarë ndodhë në Sandžak? Pse Sandžaku, të gjitha komunat e Sandžakut nuk bashkohen në një regjion të vetëm, pse këtë e pengon Serbia? Çfarë bëjnë atje organizatat civile, pse nuk u japin të drejtë këtyre njerëzve në mënyrë që të mbledhen në një regjion? Mua më është krijuar përshtypja, zotëriu ka të drejtë, që ky është një presion I madh në mënyrë që ata të hyjnë në Evropë. Ujku qimen e ndërron por zanatin së harron.

**Besarta Vasija:** Faleminderit, zoti Fehrat! Unë megjithatë isha ndërlidhur me zotëri Bujarin, do të thotë për disponimin e shoqërisë në Serbi, edhe pse isha ndërlidhur këtu edhe me disponimin e shoqërisë në Kosovë. Do të thotë, megjithatë sa do që të jetë kjo iniciativë e mirë, ekzistojnë njerëzit që nuk mendojnë njëjtë si ne. Si në Serbi e Kroaci dhe vende të tjera, ne po ashtu kemi njerëz ose shoqata të cilët edhe në Kosovë nuk e mbështesin këtë iniciativë mu për qëllimin se ata janë për shembull për themelimin e një komisioni nacional e jo për themelimin e një komisionin rajonal.

Nga konsultimet që i kemi pasur deri më sot, është pa se sidomos kategoritë që janë më të prekura, kategoritë që kanë vuajtur më së shumti, këtë iniciativë e marrin me një rezervë ose me një dyshim apo po frikohen rreth kësaj. Edhe Nora shumë mirë e tregoi se ekziston kjo, sepse ata në njëfarë mënyre janë të prekur dhe nuk dinë çka i pret pas asaj. Unë mendoj se sado që ka njerëz që janë kundër kësaj, nuk do të thotë se edhe pse Serbia apo serbët mund të ketë ndonjë disponim të keq ndaj kësaj sepse fundi i fundit në njëfarë mënyre Serbia është e involvuar në secilën luftë, përveç asaj në Maqedoni dhe në fund

mund të dalë se duhet pranuar krimet e bëra institucionalisht, do të thotë jo si grup ose si individ sikur që e tha edhe zotëri Qerimi. Ajo që është më e mira është se ne si kosovarë nuk kemi prej çka të frikohemi. Unë absolutisht pajtohem me zotëri Qerimin kur e tha këtë. Ne nuk kemi prej çka të ikim dhe nuk kemi pse të dyshojmë në diçka nëse ne vetëm e kërkojmë të vërtetën. Sado që kanë ndodhur ndonjë krim prej individëve – shqiptarë, nuk ka ndodhur prej shqiptarëve si popull, nuk kemi pasur ne institucione, nuk mundemi ne kurrë të akuzohemi se shqiptarët kanë bërë krime institucionale. Prandaj, më së paku shqiptarët kanë drejtë të dyshojnë në këtë ose të frikohen prej nxjerrjes së fakteve prej së vërtetës. Është e kuptueshme ndoshta me qenë skeptikë rreth secilës iniciativë, jo vetëm prej kësaj, prandaj ky është një hap i madh i cili nuk është bërë kurrë më herët, pra prej shtatë shteteve me lypë drejtësi. Është një hap shumë i madh dhe normalisht është shumë vështirë të arrihet të ulemi, që ka se një familje nuk mund të merret vesh, e lere më shtatë shtete, është shumë më vështirë.

Nëse nuk ka tjerë të paraqitur... Urdhëro zotëri!

**Azem Pula:** Jam Azem Pula, anëtar i Shoqatës së invalidëve të luftës. Desha të pyes, sa kemi të drejtë të punojmë rreth informacioneve dhe a do të ketë pengesa nga dikush. Në momentin kur marrim informacione a do të jemi të penguar nga ndokush, nga institucionet shtetërore. E dyta, kur jemi për komisione. Unë mendoj se në komisione duhet të kemi edhe disa në sektorë të ndarë. I pari duhet të sektori i viktimave, një sektori të burgosurve, sektorit të zhdukurve, sektori i përdhunimeve të kryera gjatë luftës si dhe një komision i veçantë për dëmet ekonomike kur dihet se në Kosovë kanë ndodhur këto gjëra. Po i flas këto nga eksperiencia sepse njëkohësisht edhe jam master i kriminalistikës si dhe më e rrezikshme është zinxhiri, ruajtja e sekreteve. Në momentin kur zbulon diçka pa u dorëzua në zyre tënde ta zbulon ndoshta një i yti, sepse ne shqiptarët e rrahim gjoksin fort dhe i zbulojmë gjërat pa i shti nën dry. Kjo është.

**Nora Ahmetaj:** Këta sektorët për veprat e kryera, vepra të shkeljes së drejtave të njeriut që i cekët, të cilat shumë mirë i cekët, do të përcaktohen në mandat dhe sugjerimet i keni të gjitha me vend. Bash mu kujtua se të gjitha këto sugjerime që i ndatë në sektor i ka pas komisioni për të vërtetën dhe krimet e luftës i Kilit dhe ata kanë pas sukses bile me i nxjerrë pastaj reparacionet, dëmshpërblimet për të gjitha këto kategori. Ndoshta do të ketë edhe sektorë të tjerë, ndoshta do të ketë sektore të shkeljes së drejtave të njeriut. Ju i përmendët edhe dëmet e luftës. Fantastike! Kjo ende nuk është përmendur askund. Mirëpo, sa i përket pyetjes së parë, ju thatë çfarë është lidhur me informatën dhe çfarë informata ju jepni.

**Azem Pula:** Po, kur t'i marrim informacionet kuptohet, a do të kem pengesë nga institucionet, për momentin, nga policia apo nga dikush tjetër. E di që kemi, sepse të 99-tën të njëjtin problem e kemi pas.

**Nora Ahmetaj:** Ju nuk merrni kurrfarë informate. ....

**Azem Pula:** Jo, po mendoj komisioni, jo për veti.

**Nora Ahmetaj:** Kur të formohet komisioni dhe merret vesh dhe kjo marrëveshje ka me qenë se i takon parlamentit të vendosë dhe i takon edhe ekzekutivit me marrë vendim. Atëherë, të gjitha institucionet duhet të jenë në gatishmëri dhe me dhënë informata për të gjitha çka kërkon komisioni. Absolutisht kanë me qenë në shërbim të komisionit, edhe policia, edhe qytetarët, edhe organizatat joqeveritare, edhe mediat. Absolutisht ajo ka me qenë dekret, do të jetë urdhër, marrëveshje dhe informatat do të shkojnë në dobi të viktimave, pra për zbardhjen e rasteve.

**Azem Pula:** Atëherë, le të jetë edhe një kërkesë, se çdo informacion i dhënë nga qytetarët le të jetë edhe i shpërblyer, përndryshe atë e fsheh.

**Nora Ahmetaj:** Edhe kjo mund të hy si propozim.

**Azem Pula:** Po unë si propozim po e bëj atë, sepse kemi që dikush nuk flet, sepse shumica thonë gjithmonë ne po flasim e s'po paguhemi a diku tjetër informacioni paguhet, kurse pala tjetër ta blenë informacionin sepse e zbulon një të vërtetë të dikujt tjetër, ose e fshehë.

**Besarta Vasija:** Desha të lidhem lidhur me këtë se sa mund të kemi qasje në informacione si komision. Nora, si shpeshherë që ka qenë paneliste dhe me përvoja të tjera, mund të më plotësoj nëse diçka gaboj. Në disa komisione, po më duket sidomos në komisionin e Afrikës së Jugut komisioni mund të ketë aq shumë autoritet sa që ka pas drejtë edhe në bastisje nëse dikush nuk ka dashtë me dhënë informacione. Kjo varet se sa ka autoritet komisioni. Dhe normalisht se më së shumti autoritet ka me pas nëse ky aprovohet prej parlamentit. Do të thotë, nëse kjo shkon nga parlamenti atëherë ka me pas shumë më shumë autoritet dhe nëse ka nevojë do të mund edhe të bastisë, nëse ka nevojë edhe për njerëzit që e dimë se kanë informata me i detyruar në njëfarë mënyre me i dhënë ato informata. Pikërisht për këtë arsye duhet të jetë në nivel zyrtar, pra kur shteti këtë e aprovon atëherë nuk mundet vetë shteti t'i ndalojë ose policia t'i ndalojë ty informatat. Prandaj, nëse e formojmë një komision për shembull të Kosovës, kurrë për jetë ne nuk kem me pas shans me kalua kufirin me shkua në Serbi e me i kërkua ato dokumente, ato informata. Absolutisht kurrë! Po, nëse themelohet ky komision rajonal, atëherë ata do të jenë të detyrueshëm të na i dhënë ne informatat dhe ato informata nuk do të mbesin vetëm në Beograd ose diku, në Bosnjë, për tu friksuar se humbin. Secila informatë, secili dokument ka me qenë në vendin e vet, aty ku është zbuluar dhe plus ato kanë me qenë të fotokopjuar apo edhe në vende tjera të cilat nuk do të manipulohen me ato dokumente në vende të ndryshme.

**Azem Pula:** Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Urdhëroni, zotëri!

**Ejup Kabashi:** Përsëri Ejup Kabashi. Unë dëgjova shumë diskutime të frytshme por po më duket ngapak po e tregojmë një pesimizëm në sukses. Ende pa filluar, po frikohemi se do të jemi të suksesshëm. Në qoftë se është vullneti i mirë dhe po e shoh se këtu është më tepër çështje humanitare, nga humaniteti i madh që të identifikohet kriminelin dhe të zbardhet krimi, unë po ju them shumë singerisht vullnetar i madh i juaji do të jem për mbledhjen e çdo informacioni dhe jam i hapur në çdo moment, do ta keni mbështetjen dhe së paku, tentativa të mos mungojë. Kurse, sukseset varen, normal, nga të gjithë ne. Mirëpo, nuk duhet të hezitoni në punën tuaj. Duhet të tregoni guximin dhe në qoftë se e keni guximin, pavarësisht, unë e di se keni me pas sukses. Në qoftë se mungon guximi, mos i hyni kësaj pune se goxha vështirë e keni. Juve ju uroj suksese. E keni mbështetjen e Organizatës së veteranëve të luftës në Rahovec me të gjitha ato dy shoqatat tjera, por do të ju gjejmë edhe njerëz bashkëpunëtorë të cilët janë marrë me këto gjëra për hulumtimin dhe gjetjen e të gjitha atyre krimeve që kanë ndodhur dhe do të jemi të hapur në çdo rast, vullnetar pa asnjë kompensim. Vetëm le të zbardhet e gjithë ajo që ka ndodhur. Ju faleminderit edhe një herë!

**Besarta Vasija:** Falemnderit, zotëri Ejup! Nora, urdhëroni!

**Nora Ahmetaj:** Faleminderit që ju po e tregoni gatishmërinë për t'u bashkëngjitur. Ne ende jemi në proces të konsultimeve deri në qershor të këtij viti dhe ky proces është kah

zgjat gati tri vite. Në Kosovë ka filluar në mënyrë më të ngjeshur prej vitit 2008. Brenda 2-3 muajve do të fillojë përpilimi i modelit dhe aty do të jenë edhe ekspertët nga Kosova, prej të gjithë rajonit modeli për komision dhe do të fillojë kampanja për ta informuar popullatën në secilin shtet dhe do të bëjmë profesionistë të cilët do ta informojnë popullatën e gjerë, jo vetëm grupet sikur ju për shembull që jeni direkt viktima ose familjarë të viktimave apo veteranë por e gjithë popullata do të sheh se çka po ndodh, diçka po ndodh, diçka po zihet këtu në rajon dhe do të fillojë mbledhjen e nënshkrimeve për atë se a jeni apo nuk keni për këtë komision. Ju do të informohen edhe përmes medieve por do të shkohet që një në njëzet banorë të japë nënshkrim. Kjo bëhet në secilin shtet konform numrit të popullatës. Në Kosovë nevojiten me u mbledh diku 110.000 nënshkrime dhe tek 2011 deri në qershor qeveritë do t'i marrin nënshkrimet dhe modelin të cilin ne do ta përpilojmë dhe do t'ia ofrojmë Qeverisë së Kosovës dhe Parlamentit. Çka bëjnë pastaj ata, ne nuk e dimë.

Do t'ua jap edhe vetëm një të dhënë. Parlamenti i Afrikës Jugore, e ka debatuar punën e komisionit të së vërtetës dhe amnistisë që e kanë pasur atje 300 orë. I është dashur 300 orë të debatojnë atë punë.

Tash po ua jap edhe një pasqyrë se çka e pret pastaj komisionin tonë, e t'i lëmë anash komisionet rajonale, por vetëm sa Parlamenti i Kosovës mund ta debatojë këtë punë dhe pastaj mos ta lë anash, ka me pas me siguri presion shumë të madh të bashkësisë ndërkombëtare nga se vetë Brukseli, vetë komuniteti evropian nuk është shumë unik rreth kësaj çështjeje dhe ne i dimë politikat e tyre. Ka shtete të cilat e përkrahin shumë idenë, ka shtete që thonë – ti marrim ne këto shtete një nga një brenda në komunitetin evropian e pastaj ne ato i rregullojmë sipas kriterëve tona dhe ka aso shtete që thonë ne kemi investuar mjaft në Ballkan me themelimin ose financimin e Tribunalit të Hagës kështu që nuk janë shumë unikë edhe ata mirëpo presioni do të jetë shumë i madh.

Unë dua të ju tregoj se në momentin kur mblidhen nënshkrimet, depozitohen nënshkrimet dhe modeli i KOMRA-s ose REKOM-it në parlament dhe atëherë ne na mbetet vetëm të presim se çka do të vendosin ata. Nëse pranohet dhe ne mendojmë se do të pranohet ky komision prej krejt parlamenteve dhe e fillon punën, atëherë puna jonë – e shoqërisë civile do të jetë që përafërsisht të monitorohet puna e rekomandimeve të këtij komisioni. Sepse, nuk ka dyshim, ka komisione të cilat kanë qenë shumë efektive e të suksesshme dhe ka komisione që kanë zhagitur punën e kjo varet nga menaxherëve, varet prej komisionarëve që kemi me i zgjedh, varet sa do të jenë ata ekspeditivë dhe shtyjnë gjërat me gjoks mirëpo vetëm me ju dhënë përafërsisht njëfarë pasqyre se çka na pret ne nëse në momentin kur ky komision pranohet dhe fillon të punojë, e atëherë nga ju na nevojitet ndihma juaj dhe atëherë ju duhet të bëni presion që qeveria dhe eventualisht komisionarët t'i zbatojnë pikë për pikë rekomandimet e atij komisioni.

**Besarta Vasija:** Vildane?

**Vildane Minci:** Unë desha një mendim tjetër, pak më pozitiv ta sjell. U përmend skepticizmi, u përmend pajtimi por pajtimi shumë mirë u përmend edhe në dokumentarin që e pamë. Do të thotë çfarë kuptimi ka pajtimi në këtë problematikë, në këto rrethana ose për këto çështje me të cilat po merremi. Pajtimi në atë kuptimin e trajtimit të njëri-tjetrit në një formë tjetër, jo në një formë të armiqësisë ose çdoherë të shihet me një sy të armikut njëri me tjetrin. E kam fjalën për shtetet fqinje, por të një trajtimi të drejtë dhe nivel të barabartë. Pajtimi në këtë rast e ka atë kuptim për mua.



Për me arritur deri te pajtimi duhet të arrihet një kërkim-falje. Për të ardhur deri te një kërkim-falje duhet të gjendet fajtori. Për t'u gjetur fajtori duhet me u gjend edhe aktori që ka qenë pjesë e atij faji, ose pjesë e atij krimi. Prandaj, të nisemi nga kjo mënyrë e të menduarit dhe ndoshta do të kemi pak më tepër optimizëm. Faleminderit!

**Nora Ahmetaj:** Nuk e di a e patë në fund të filmit? Për mua çasti më i prekshëm është kur komisionarja që është qileane nuk është aburugjine nga se qeveria Pinoçe ka abuzuar me njerëzit aborigjenë – indigjenez dhe ajo kur në emrin e vet personal dhe në emrin e popullit të vet, sepse ajo i përket një kaste shumë të lartë dhe shumë të shkolluar në Kili, ajo kërkoj falje dhe tha mua po më vjen keq dhe turp që unë nuk e kam ditur çka i ka ndodhur popullit tim. Do të thotë kanë qenë krejt verbërisht të manipuluar prej qeverisë, derisa qeveria i ka masakruar njerëzit aborigjenë atje në Ande. Popullata në kryeqytet dhe vendet urbane, nuk e kanë pas idenë çka ka ndodh.

Problemi i kërkim-faljes në disa konsultime ka intriguar debate të shumta dhe unë ju kisha lutur që edhe ju ta thoni mendimin tuaj nga se në konsultimet me gra që i kemi pas, me rrjetin e grave në Kosovë, gratë kanë insistuar të jenë në mandat të komisionit kërkim-falja. Dhe çka mendoni ju, është koncept shumë i gjerë dhe ne mund të debatojmë nga aspekti filozofik se çka është kërkim-falja, çka është pajtimi dhe kjo fjala e pajtimit ka shumë implikime tjera. Mirëpo, ju si e shihni. Pra, paramendoni, nëse ky komision kishte me u formua dhe në gjithë rajonin televizionet publike i qesin dëgjimet publike të dëshmitarëve të nacionaliteteve të ndryshme. Sa kishte me pas efekt te popullata dhe sa kishte me pas efekt te të rinjtë dhe paramendoni një komisionar i cili, qëllon për shembull komisionar qoftë serb, boshnjakë, kroat, shqiptar, maqedon, slloven, kishte me reaguuar sikur ajo komisionerja në Kili dhe kishte me thënë: unë nuk e kam ditur çka ka ndodhur në këtë vend dhe kërkoj falje në emër të popullit ose në emrin tim personal. Këtë unë po ua lë juve ta debatoni, nuk po e jep mendimin tim personal por kjo në film mua më ka prek dhe ju si e përjetuat, çka mendoni ju pra që kërkim-falja do të sjellë.

**Azem Pula:** Unë mendoj se kërkim-falja mund të dalë vetëm nga parlamenti i shtetit i cili e ka bërë krimin dhe gjenocidin në Kosovë, nga skush tjetër, e në këtë rast është Serbia, sepse personi që e ka kryer këtë në këtë rast është i vdekur. Kështu që gjithçka çka del nga parlamenti serb për kërkim falje, është edhe për ne, kurse nga goja tjera që dalin nëpër biseda e nëpër mbledhje është i pavlefshëm. Pse? Sepse jemi shtet edhe ne.

**Besarta Vasija:** Urdhëroni, zotëri Fehrat!

**Ferhat Dervish:** Vetëm për kërkimin e faljes, nga parlamenti apo dikush tjetër, popullit ose kryetarit. Sa është i sinqertë ai kërkim i faljes prej një populli? Këtë duhet ta dini. A kanë arsye të kërkojnë falje prej një populli ndaj të cilit kanë bërë krim. A kanë arsyetuar atë faljen që do ta kërkojnë prej atij populli. Një herë atë duhet ta bëjnë e pastaj të kërkojnë falje. Jo të kërkojnë falje se ne duhet të shkojmë në Evropë!

**Besarta Vasija:** Faleminderit! Zotëri Azem?

**Azem Pula:** Unë mendoj që po ekzagjerohen gjërat dhe po kalohen, sepse ne po futemi komplet në politikë dhe është vetëm e udhës e gjithë kjo nëpërmjet parlamentit dhe kur flet parlamenti ajo diskutohet diku tjetër, në opinionin e vet. Kështu, sepse ne e dimë që gjyqi është t'i kryejë këto punë por për momentin nuk i kryen.

Besarta Vasija: Urdhëro, zotëri Ejup!

**Ejup Kabashi:** Vërtet nuk kam menduar se do të hyjmë në këtë temë, por ja që po insistohet. Dëgjoni! Unë po të isha familje e dëshmorit, të isha vet dëshmor i kombit që s'e kam atë nder dhe nuk dua të hyjë askush në histori personale sepse ne kemi për çka të

punojmë. Nëna ime nuk ka pasur nevojë t'i kërkoj falje Serbisë pse është vra djali dëshmor. Absolutisht! Sepse unë me vetëdije kam luftua për vendin tim. Ushtria çlirimtare e Kosovës, me bindje të plotë dhe me argumente shumë të fuqishme e mbroj, sepse jam në një trevë ku më së shumti kemi të akuzuar për krime lufte, do të thotë vi nga Rahoveci që janë ushtarët e Ushtrisë çlirimtare të Kosovës mbi 47 në listë për krime lufte. Jam në gjendje me çfarëdo gjyqi të përballem, ta marr përsipër peshën e luftës se Ushtria Çlirimtare e Kosovës e ka pasur pastërtinë më të madhe të luftës, se unë e di si ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kemi pasur kodin e etikës së luftës se si duhet të sillemi qoftë edhe ndaj ati të vrari që ka qenë armiku ynë. Do të thotë këtë e ka mbrojtur me fanatizëm Ushtria çlirimtare e Kosovës.

Kërkim-falja mendoj se është një term shumë i gjerë. Nuk pajtohem se as parlamenti serb të kërkojë një kërkim falje. Së pari duhet të gjenden faktet pse Serbia duhet të kërkojë falje. Duhet të analizohet shumë se edhe ajo kërkim-falje a është e mjaftueshme. Un nuk pajtohem kurrë në asnjë mënyrë që Serbia, ja tash, për hir të vetes dhe për interesat e veta, për integritet evropian detyrimisht ka me thënë që unë nuk pajtohem dhe ne jemi distancuar nga politika e Millosheviqit vetëm e vetëm që të arrijë qëllimet e veta politike. Kujtoj se shumë gjëra ende nuk është momenti të bisedohen. Kujtoj. Ndoshta, sepse ende kemi atë urrejtjen, urrejtjen ndër palëve të ndryshme.

Organizata e veteranëve të luftës së Serbisë, hyni në ueb-faqe të tyre, se unë zakonisht hy dhe kontrolloj. Ata kanë njësitet speciale, do të thotë që sot brenda organizatës së veteranëve të Serbisë përgatiten për luftë të ashpër në Kosovë. Jeni të bindur, hyni në ueb-faqe sepse kanë, dhe ne kemi organizuar si organizatë.

Organizata e veteranëve të luftës e Kosovës sot është një mekanizëm që i kontribuon paqes. Me plot bindje po e them. Prandaj, ndoshta dhe nuk di, nuk jam shumë i përgatitur për këtë temë të kërkimit të pajtimit ose kërkim-falje por kujtoj se vërtetë është një temë shumë e prekshme dhe së pari s'besoj se familjet kanë me qenë të kënaqura, ata që janë viktimizuar.

Edhe një herë, ju falënderoj për iniciativën, keni guxim, vazhdone punën.

**Nora Ahmetaj:** OK. Atëherë po ju bëj një pyetje: çka kishte me kthye dinjitetin e viktimave?

**Ejup Kabashi:** E vetmja mënyrë që mund ta kthejë dinjitetin e viktimës është zbardhja e fakteve dhe ulja e kriminelit në bankën e akuzës. Do të thotë, faktikisht, aparati shtetëror i Serbisë ka qenë i involvuar në luftërat në ish-Jugosllavi komplet dhe duhet të gjykohe sikur aparat shtetëror. Do të thotë, individit nuk është me rëndësi dhe se a do të dënohet Stojani a Jovani, një polic i thjeshtë. Aparati shtetëror, zinxhiri komandues. Ne ia kemi dhënë Tribunalit të Hagës, kryetari i komunës së Rahovecit ka qenë Gjeka Kollashinac, i është bërë gjykimi pas luftës. Ai ka qenë komandanti i forcave të armatosura në komunën e Rahovecit dhe sot është i lirë. I kemi mbi 1.300 të vrarë. Ju lutem, komandën kryesore e ka pas Gjeka Kollashinac dhe i është bërë gjykimi por nuk ka qenë i drejtë. Do të thotë është liruar, zotëria jeton. Ne viktimat për çdo përvjetor në Krushë të madhe varrosim nga dy a tre, pas dhjetë viteve luftë. Çdo ditë e më shumë hapen plagët. Do të thotë e vetmja punë për kthimin e dinjitetit është zbardhja e fakteve dhe ulja në bankë të akuzës kriminelin. Unë mendoj kështu dhe ndaj mendimin besoj të gjithë atyre qytetarëve sepse jam në kontakt të përhershëm me ta. E di brengën e tyre dhe i di shqetësimet e tyre. Prandaj, e vetmja mënyrë është zbardhja deri në fund të rasteve dhe akuzimi i zinxhirit komandues. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Faleminderit! Unë desha një sqarim të vogël, lidhur me çështjen e pajtimit dhe çështjen e kërkim-faljes.

Do të thotë sa për informatë, as pajtimi e as kërkim-falja nuk janë qëllim i këtij komisioni, do të thotë që po domi ne ta themelojmë.

Ajo që u tregua, do të thotë që ishte Komisioni i Perusë, ekzistojnë komisione të ndryshme që kanë qenë në botë të cilat në bazë të asaj se çka hulumtojnë dhe kërkojnë edhe quhen. Për shembull ajo e Perusë është quajtur Nunkamas dhe është quajtur komisioni i së vërtetës dhe i pajtimit. Do të thotë qëllim e kanë pasur atë, prandaj kaq shumë diskutohet pajtimi aty.

Ne këtë iniciativë që e kemi nuk është qëllim pajtimi ose kërkim-falja. Këto tema kanë dal si rrjedhojë e konsultimeve paraprake që i kemi pas ku pjesëmarrësit i kanë ngritur si çështje. Ka njerëz që mendojnë, sidomos prej psikologëve se pajtimi në njëfarë mënyre jo vetëm se i duhet atyre që kanë bërë krime por edhe vetë viktimës ku viktimat e ndjen atë se po pranohet si viktimë prej personi që e ka kryer krimin mbi të. Dhe, ka persona që kanë thënë se: ne nuk domi kurrë të bashkëpunojmë me Serbinë deri sa nuk kërkon falje.

Pra këto janë çështje vullnetare që i kanë shprehur njerëzit pjesëmarrës. Por, duhet ta kemi të qartë se nuk është qëllim i kësaj iniciative. Prandaj, nëse vjen dikur kërkim-falja si pasojë e krejt kësaj është diçka tjetër. Mund të mos vjen kurrë, po mundet edhe pas kësaj të mos ketë as pajtim as kurrëgjë. Do të thotë, nuk është ky qëllimi. Këto janë tema të cilat vetëm po dalin nga konsultimet dhe ta kemi të qartë. Qëllimi i kësaj iniciative është të gjenden faktet për krime të luftës, me qenë të dokumentuara se çka ka ndodhur, të zbardhet fati i të zhdukurve. Do të thotë të arrihet deri te zbardhja e së vërtetës. Pra, nuk është as pajtimi as kërkim-falja. Pra mos të keqkuptohet dhe temat që janë këtu të mos shihen si diçka që po kërkohen, por temat që janë – janë se kanë dal si rezultat prej konsultimeve të ndryshme ku pjesëmarrësit e ndryshëm i kanë shtruar këto çështje.

Dikush tjetër, nëse ka diçka? Nëse jo, atëherë unë kisha kaluar në një temë tjetër. Është raporti i komisionit ndaj kryerësve të krimeve.

Edhe prej konsultimeve të kaluara por edhe prej përvojave të komisioneve tjera i kemi dy komisione të ndryshme të cilat komisione kanë menduar se duhet të përfshijnë edhe kryerësit e krimeve. Po ashtu ka që mendojnë se nuk duhet të përfshihen në ato komisione kryerësit e krimeve. Çka mendoni ju, çfarë raporti duhet të ketë ky komision, përndryshe KOMRA ndaj kryerësve të krimeve – a duhet me i përfshi edhe ata, a duhet të merren edhe deklaratat e tyre, apo a duhet ata të emërohen prej viktimave publikisht ose rekomandimi kur të del, se zakonisht, pasi të mbaron faza e hulumtimit të verifikimit, komisionet dalin me një raport. Raporti përmban edhe rekomandimet. Pra, a duhet të zbulohen emrat që, për shembull, një zotëri thotë: filan fisteku, e kam pa me sytë e mi, e ka vra këtë e këtë, e ka masakruar e tjera. A duhet pra të përmendet ai kryerës i krimeve me emër e mbiemër. Ose në dëgjimet publike. Ose a duhet me i marrë deklaratat edhe nga kryerësit e krimeve, sikur që kemi rastin atje në Afrikën e Jugut ku edhe krim-bërësit në njëfarë mënyre e pranojnë atë që e kanë bërë ose, nëse kanë qenë të përfshirë në atë njësit, edhe nëse nuk e ka bërë vet ka qenë aty, apo nuk duhet lejuar atyre të jenë të involvuar në këtë komision. Pra, çka mendoni ju? Urdhëroni, zotëri!

**Ejup Kabashi:** U bëra zakonisht aktual, por ja që temat janë jashtëzakonisht interesante. Besarta unë kujtoj që për të ardhur deri te burimi dhe saktësimi i të gjithë asaj se çka ka ndodhur, faktikisht duhet të gjendet aktori. Ne shumë herë po e potencojmë dhe me mendjen tonë gjithmonë e kujtojmë. Unë pa diskutim mund të them se për ta gjetur vërtet

fajtorin kryesor, ose kriminelin në këtë rast se ndoshta po e përdorim një metodë tjetër, kujtoj se nëse e kemi një burim dhe nëse vërtet ai nuk ka qenë kryerës ose aktor i drejtpërdrejt ai do ta gjen burimin se nga kush i ka ardhur ai urdhër. Do të thotë, detyrimisht se për të zbardhur faktet duhet të bisedohet ose të konsultohet në qoftë se në këtë rast aludohet te një person që ka qenë kryerës i veprës dhe ne kem mundësinë, do të thotë komisioni ose ata njerëz që punojnë për zbulimin dhe gjetjen e fakteve pse të mos i afrohen dhe të bisedojnë me të. Unë po i përcjell disa ngjarje shumë interesante. Kur ai që e kryen krimin faktikisht i afrohet gjykatës, i afrohet, sepse e ka barrë shpirtërore atë pse e ka bërë. Do të thotë kjo është ajo ndërjegjija e një njeriut, ta vrasë një njeri, do të thotë të pafajshëm detyrimisht se ai kurrë nuk ka me qenë në jetën e vet i qetë. Prandaj unë kujtoj se patjetër edhe në këto komisione dhe në gjetjen e fakteve duhet të jenë të involvuar, në qoftë se aludohet në dikend. Unë di që mundësitë janë të mëdha, vetëm duhet me pas vullnet. Prandaj, unë nuk e përjashtoj mundësinë do të thotë me arritur deri te burimi i informacionit të saktë dhe të bisedohet edhe me kryerësin e veprës.

**Besarta Vasija:** Faleminderit! Urdhëro, zotëri Bujar!

**Bujar Ukimeraj:** Besarta, edhe unë desha tash me u kyç. Është shumë interesant tash, ka tema të gjera dhe shumë me rëndësi dhe shumë prekëse e shpirtërore. Krejt është, por më shpirtërore është këtu ndër ne. Shih sa ishim, dhe erdhën në mëngjes, ata që vijnë sa për syreta ose për misione të caktuara ose për detyra me marrë informacione si puna e sigurimit të KFOR-it gjerman e tjerë, unë i njoh këta. Shih kush mbet këtu. Mbetën ata që i kanë prekur në shpirt, ata që kanë përjetuar më së shtrenjti ose që kanë dhënë më së shtrenjti, kurse të gjithë ata që e kanë për afera ose për para ose për publicitetin e ikin. Ja kush kemi mbetur këtu. Prandaj, kur e thash në fillim, filloni prej bazës, mos e merrni sepse jemi ngopur me do deputeta, parlamenta, figura publike, politike dhe na është bërë monotim, sepse gjithmonë opinga e ka paguar në luftë me kurriz dhe opinga i jep faktet, nuk janë më ata që i mbajnë kravatat në qafë dhe sa u është xhepi i thellë e i trashë. Prandaj ky le të jetë një model si pikënisje dhe shihni se kush kemi mbet. Ose, i falënderoj këta dy zotërinjtë ha e kanë diku në Bosnje iu është vra ndonjë mik a dashamirë dhe këtyre u dhemb, më falni, ja janë shpirtmirë që i dhemb për mua, e kanë ndershmërinë e vet si njerëz, se ata që nuk kanë ndjesë veç u avulluan prej këtuhi. Më falni!

**Besarta Vasija:** Faleminderit! Unë kisha pas dëshirë edhe prej zotëriut dhe të tjerëve, le të involvohen të gjithë në debat sepse kjo është një çështje që u takon të gjithëve. Unë thash, ne si viktima nuk jemi vetëm për familjet që na dhemb, por ne si shoqëri jemi të gjithë viktima. Edhe ne që kemi qenë shumë të ri kur ka qenë lufta, por megjithatë ne të gjithë si shoqëri jemi traumatizuar dhe ne të gjithë duhet të rehabilitohemi pa marrë parasysh nacionalitetin. Prandaj, unë kam dëshirë që të involvoheni të gjithë në këtë debat dhe të gjithë ta thuani atë çka mendoni.

**Bujar Ukimeraj:** Jo unë e pata për respekt se më shumë po më kënaqë kjo që i sheh këta dy zotërinjtë këtu që edhe me përktimë i dëgjojnë llafet e mia se ne që jemi pjesë dhe që e mbajmë një copë hekur në kokë. Shumë rrespekt për ta, që kanë ndershmëri me na dëgjua neve.

**Besarta Vasija:** Faleminderit! Udhroni, zotëri Azem!

**Azem Pulaj:** Besarta, tash u futëm aty ku jetoj edhe vetë. Është problemi kështu! Tash jem te zbulimi, deklarata, analiza, shqyrtimi, akuza, gjetja e personit i cili e ka bërë krimin. Është shumë problem. Ne mund të shkojmë deri te akuza të cilën mund ta ngritë

vetëm organi shtetëror, jo ne. Po ne si komision, pra nëse bëhet komisioni, mund të shkojmë deri në shqyrtim ose në akuzë, që pastaj mund t'ia dorëzojmë vetë organeve shtetërore apo gjyqësisë. Ky komision le të merret me komisionet ndërshtetërore. Nëse komisioni ynë i ka të gjitha faktet, argumentet se është kryer një krim, duhet të bisedojë vetëm me komisionin e shtetit fqinjë. Kurrësesi ne të merremi me të, sepse një serb as që dëshiron të flas me ne e jo të japë një deklaratë çfarë ne na nevojitet. A kuptoni? Kaq!

**Besarta Vasija:** Falemnderit! Urdhëroni, zotëri Fehrat!

**Fehrat Dervish:** Desha të them se puna e komisionit është... Ne një luftë e kemi kaluar, janë viktimat, por në këtë komision duke punuar dhe mbledhur të gjitha këto shënime, duke treguar se çfarë krime janë bërë, ndoshta është shembull i mirë për të ardhmen, për fëmijët, për nipat tanë, që mos të ndodhë prapë kjo. Tash vetëm për këtë duhet të luftojmë, mos të përsëritet diçka e tillë. E si duhet e çka duhet të bëjmë, le të ndalen më këto krime në Ballkan, të ndalen luftërat e të shkojmë sa më shpejt përpara.

Po më duket, për këtë duhet të luftojmë më së shumti.

**Besarta Vasija:** Falemnderit zotëri Fehrat! Do të thotë, një prej brengave kryesore dhe qëllimeve tona kryesore është parandalimi i përsëritje së luftërave që kanë ndodhur. Ne assesi nuk mund të parandalojmë këto, nëse ne lejojmë të kemi histori të ndryshme secili vend dhe assesi nuk mund të parandalojmë nëse rriten fëmijët tanë duke i helmuar ata kundër tjerëve, do të thotë gjithmonë duke iu thënë fëmijëve se ne jemi viktimat e tjerët janë gjithmonë fajtorë. Prandaj, nëse nuk i kanë ata ato dokumentet e faktet përpara që tregojnë çka ka ndodhur, gjithmonë do të rriten me atë urrejtje dhe në njëfarë mënyre gjithmonë ne duke i mitizuar veprat e kaluara nga e secilit nacionalitet për veti dhe, gjithmonë, duke e rritur fajin e atij tjetrit. Mirëpo, kur ne kemi diçka të saktë, një dokument të saktë të cilin mund t'ua ofrojmë nxënësve së pari, që ne t'i ndihmojmë me u rritë në kushte normale dhe jo gjithmonë traumat tona ata me i trashëguar pastaj, ne kurrë nuk do të mund t'i parandalojmë ato gjëra.

Prandaj, nuk është kjo vetëm për hir tonin, ose vetëm për hir të atyre që kanë vdekur, por edhe për hir të atyre që do të jenë nesër.

**Fehrat Dervish:** Besarta, edhe diçka! Komisioni duhet të ketë të dhëna me fakte se ne kemi qenë viktimë. Dikush i ka bërë këto krime dhe ata që i kanë bërë krimet duhet të turpërohen. Gjithë në atë historinë e vetë duhet ta kenë atë pikën e zezë, do të thotë ata që kanë bërë krime, edhe nipat, edhe djemtë gjithmonë të turpërohen prej këtyre krimeve dhe atëherë do të ketë falje dhe mund të kërkojë falje e me thënë se po turpërohem se çka kanë bërë gjyshërit tanë ose babit tanë.

**Besarta Vasija:** Falemnderit! Dikush tjetër? Urdhëro, zotëri Aqif!

**Aqif Ilazi:** Edhe një herë, përshëndetje! Aqif Velazi! Vetëm desha ta di një gjë, nëse ka mundësi pak më gjerësisht. Sa ka me qenë i fuqishëm ky komision në esencë, në kuptimin nëse mblidhen ato materiale sa do të mund ta çojnë deri në fund drejtësinë, në kuptimin që në njëfarë forme të detyrohet gjykata të ndërmarrë një proces të caktuar ose diçka të ngjashme sepse deri diku dihet edhe sot, unë po e them simbolikisht, nëse s'gaboj – nëse s'gaboj po e them, simbolikisht: Mlladiqi është diku kah Berlina sepse e ka pasaportën biometrike, a kuptoni. Janë çështje shumë esenciale, dihet krimi. Sa do të jetë i fuqishëm ky komision në njëfarë forme ta detyrojë atë dhe a do të jetë një veprimtari pasuese pas kësaj që do të shihet fuqia e këtij komisioni. Këtë dua ta di.

**Besarta Vasija:** Përveç asaj që thamë në fillim se shoqëria civile nuk mund ta themelojë këtë komision, mirëpo kjo nuk do të thotë se shoqëria civile do të jetë e distancuar dhe

nuk do të bëjë asgjë. Roli ynë prapë fillon aty kur themelohet ky komision, prandaj kur themelohet komisioni dhe ne i shohim se ato rekomandime, për shembull, nuk merren parasysh ose e shohim se nuk po shkon diçka në rregull, atëherë ne jemi që të bëjmë presion, pra ta vëzhgojmë atë punë, dhe të bëjmë presion aty ku nuk shkojnë punët në rregull. Për këtë ne po domi të jetë kjo e aprovuar prej parlamentit sepse nëse nuk aprovohet kjo prej parlamentit ose nëse themi bëhet me një marrëveshje paqësore apo diçka tjetër, nuk do ta ketë atë autoritet sikur që fola edhe më herët për me i detyruar njerëzit t'i zbatojnë rekomandimet nga raportet e komisioneve.

Po them, nuk do të jetë kjo se një komision që do të bëhet tash, do të bëhet ky komision, do të hulumtohet puna dhe në fund, dhe u krye kjo ose – ju në shtëpi, ne në shtëpi. Jo! Absolutisht, sepse për këtë jem ne këtu si shoqëri civile për të mos hequr dorë, mos të punojmë pa interes, do të thotë të kemi ne këtë parasysh se nuk kemi kurrfarë përfitimi, ndoshta asnjëri prej nesh nuk do të jetë komisionar por ne do të jemi ata gjithmonë si opozitë aty, me shikua çka po ngjanë dhe me i detyruar ata për me i zbatuar rekomandimet tona. Urdhëro, zotëri Bylbyl!

**Bylbyl Duraku:** Bylbyl Duraku, nga Shoqata e të burgosurve politikë. Sa i përket përfshirjes së aktorëve – të kryerësve të krimeve se a duhet dhënë deklaratat apo jo. Unë do të kisha thënë se duhet me iu dhënë shansë të japin deklaratat, vetëm atëherë kur pendohen. Asnjëherë, në asnjë rast tjetër. Kaq!

**Besarta Vasija:** Urdhëroni, dikush tjetër? Po, zotëri Azem!

**Azem Pula:** Unë nuk pajtohem me kolegun, sepse më mirë është ta japë deklaratën se ai person i cili pendohet nuk ka nevojë të japë deklaratë, ai duhet të dënohet. Ky është proces gjyqësor. Këtë ligji e do kështu. Në momentin kur pendohesh, ti vetëm e pret dënimin. Je kaq i dënuar, ose në momentin kur t'i pendohesh je përgjysmë i dënuar, si ajo Biljana Plavshiqi, që ishte nga Bosnja.

**Bylbyl Duraku:** Bylbyl Duraku, nga shoqata e të burgosurve politikë. Unë mendoj që deklaratë duhet të apë, sikur që po thua ti, para organeve gjyqësore, mirëpo unë po them dhe e kam si propozim që para këtij komisioni për të vërtetën që është kryerësit e krimeve nuk është mirë të japin deklaratë sepse ai mund edhe të mos e tregojë të vërtetën, kështu që më mirë do të ishte që ata që pendohen para këtyre komisioneve ata të deklarohen. Ata po, kurse tjerët nuk ka mundësi. Unë jam i këtij mendimi.

**Besarta Vasija:** Faleminderit! Urdhëroni, a ka kush tjetër për ta marrë fjalën? Udhëroni, zotëri Bujar!

**Bujar Ukimeraj:** Desha edhe unë diçka të shtoj. U diskutua shumëçka dhe mirë. Ka shumë për të diskutuar dhe ka me pas nevojë. Mua më intereson sa është përkrahja prej njerëzve tanë brenda, nga shoqëria civile po edhe në anën tjetër, nga ndërkombëtarët. A janë të interesuar vërtetë të na përkrahin apo vetëm na shtinë në do lojta kështu dhe me na e mbështjell punën mirë e mirë dhe mos me dit kush kujt me i dhënë llogari. Singërisht, a po dini, prej përvojës së keqe po them. Na shtinë kështu nëpër procese gjyqësore si Albin Kurtin poshtë e lartë e këndeje dhe për zotin jemi të lodhur me këto sende. A e dini, Albin Kurti e ka dhënë një model të tillë – çojë lartë e çojë poshtë! Kështu që kam njëfarë frike se mos po na mbështjellin kështu dhe vetëm të them se po merremi me diçka, kurse vitet po kalojnë. Unë po ju tregoj edhe këtë, në vitin 2000 në njëfarë detyre isha, kam punuar në uniformë dhe KFOR-i zvicëran ma bën një pyetje, tha, a bën me të pyetur diçka personalisht: Çka mendon ti, kur duhet me i lënë ne këto, me i harrua këto sende dhe me shkua puna ndryshe? Unë i thash, valla nja 10 vjet deri të

kalben eshtrat. Doli tamam 10 vjet, filluan tash me formua FSK-ën, me formua një siguri e Kosovës dhe deri atëherë s'bën, s'bën shqiptarëve me u dhënë armë e sende, as ushtri e as kurrigjë. A dini, më kanë dhënë shumë përvoja të hidhura këto sende, po them se mos po donë me na e mbështjell punën poshtë e lartë, kalojnë vite e kalojnë sende kështu.

**Besarta Vasija:** Unë plotësisht po ju kuptoj. Po e kuptoj edhe brengën tuaj, mirëpo kjo nuk është iniciativë e bashkësisë ndërkombëtare. Nuk është iniciativë e ndërkombëtarëve, është iniciativë e shoqërisë civile prej vendeve që kanë dal nga ish-Jugosllavia. Prandaj, meqë ne nuk po i lëmë të harrohen dhe sikur që kanë thënë: hajde t'i harrojmë, ndodhi çka ndodhi, po i mbyllim këto dhe po ecim. Nuk mundemi ne me ecë përpara për deri sa ne nuk ballafaqohemi me atë se çka ka ndodhur. Nëse ne i mbulojmë, ne nuk do të bëjmë asgjë me atë. E ngrijmë ose ajo deri sa të fryhet më shumë edhe njëherë mund të pëlçasë. Prandaj, nuk është kjo iniciativë e tyre dhe ne nuk po domi të lejojmë të harrohet dhe për këtë jemi ata që po dëshirojmë të dalë gjithçka në pah dhe çka ka ndodhur vërtet.

**Bujar Ukimeraj:** Të kuptova drejt, bre Besartë! Më fal se u bëmë tepër, për zotin. Mua a di çka po më mundon? Po më mundon se gjithmonë po duhet ata që po bëjnë kërdi, po bëjnë histori, po bëjnë kërdi ata po i bëjnë konsensionet çfarë po donë. Ai po bën kërdi, ky po i thotë hajde në NATO, ai po bën kërdi po i thotë hajde në Evropë. Këto janë për mua shumë prekëse. Po frikësohem se do të bëhet diçka.

**Aqif Ilazi:** Aqif Ilazi, se u mbyta duke e thënë. Më shumë po më bie duke përmendur emrin se duke thënë diçka, a po dini.

Në esencë mendoj se vazhdimisht kërkohet prej nesh në njëfarë forme të jemi tolerantë, të jemi njerëz që falim, njerëz që jemi të gatshëm me marrë iniciativa të tilla, njerëz që i harrojmë shumë shpejt gjërat. Pse nuk është më e zëshme, pse nuk është më aktive, pse nuk është më gjithëpërfshirëse në Serbi kjo iniciativë, sepse aty është krejt shkaku, po është te ne në Kosovë. Na jemi viktimat, ne jemi rrahur, ne jem torturuar, ne jemi vra, ne na janë bërë të gjitha. Më fal, një moment, po e di çka po do me thënë. Veç një Natashë është, s'ka tjera. Edhe një Sonja, do të thotë dy individë. Paramendoni, një popullatë që i ka 9 milionë banorë i ka vetëm 2 persona. Shikoni sa kem ardhur ne këtu, i ke familjarët e dëshmorëve, i ke veteranët, i ke invalidët, i ke njerëzit që kanë përjetuar masakrat. Do të thotë jemi të gatshëm me i ndërmarrë këto veprime. Pse? Vetëm pse jem të gatshëm për me bërë gjëra të tilla, do të thotë. E ata? Ata, vazhdimisht bëjnë sjellje të tilla. Vazhdimisht sepse janë më të fortë se ne.

Nuk po dua të kthehem... Larg qoftë ajo, por me thënë dhëmbë për dhëmbë, sy për sy. Ua falim, veç kur t'ua kthejmë duplo. Ndoshta kishte me qenë pak më mirë!? Po, po. Këtë po e bën Evropa sepse po i shpërblen në njëfarë forme serbët veç pse janë forcë në Ballkan. Kjo është çështje politike në fund të fundit. Ne pa dashas po duhet të biem në ato binare të politikës. Pse po i shpërblen? Vetëm se janë faktorë në njëfarë forme stabiliteti, janë fuqi, kanë ushtri të veten. Ne u dashtë me i dorëzuar armët, çlirimtarët me i dorëzua armët, domethënë çlirimtari me heq uniformën e UÇK-ës dhe me vesh të TMK-ës, me heq të TMK-ës tash, vetëm me u shpërbërë ajo bërthamë, me e kthye në FSK, atë që e tha zotëria, e tash është e sigurt sepse kjo shoqëri është multietnike, jepja armën atij, pa dashtë me u ofendua dikush – boshnjakut, turkut, romit e atij tjetrit, se këta janë a e dini kështu... Vetëm për shkak se ne kemi treguar vazhdimisht me iu thënë pragmatizëm tamam, kemi qenë ata që kemi dashtë të bashkëpunojmë me bashkësinë ndërkombëtare, jemi dënuar në këtë formë.

Po qe se, atë që e tha edhe më herët zotëri Bujari. Nëse ne kishim me ia kthye bërrylat në njëfarë forme dhe me iu thënë: a dini çka, ndërmerrni ju diçka se ne kemi me ua nxjerrë tamam dhëmbë për dhëmbë, sy për sy – pak më ndrysh kishte qenë situata. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** Vetëm rreth asaj, se kjo iniciativë sa është e fuqishme në Serbi. Në Serbi ky lloj konsultimi ka filluar pak më herët se sa në Kosovë, pikërisht....

**Aqif Ilazi:** Të lutem, e di që ndoshta nuk është kulturë, por megjithatë, sepse mu kujtua a një fakt. Është dashur do të thotë Fondi për të Drejtën Humanitare të ndërhyjë për rastin e masakrës që ka ndodhur në Suharekë, nëse s'gaboj kështu ka qenë: e kanë familjen Berisha dhe e kanë dërguar atje. Sot serbët e kanë Graçanicën e besa ne, krejt qeveria, Republika e Kosovës mundohet me ua bë me njësi kadastrale dhe mos të hy tash në proces të decentralizimit që e kundërshtojmë ne, ajo është diçka tjetër. Në veri të Kosovës hyjnë mallra ditë e natë, do të thotë pa kurrfarë kriteresh, dhe ndodhin krejt këto gjëra.

E çka deshta të ndërliidhi, ka qenë vetëm një rast, sa janë gjithëpërfshirëse këto iniciativa dhe këto nisma në Serbi? Domethënë, vetëm një rast njihet deri më sot.

**Besarta Vasija:** Tash unë nuk po dua të hy në ato projektet tjera të Fondit dhe nuk është vetëm rasti Berisha. I kemi Bugujevcët, Duriqët, e shumë raste të tjera por në fakt kjo është për iniciativën për KOMRA dhe jo për raste tjera me të cilat merret Fondi për të Drejtën Humanitare.

Mirëpo, atë që desha ta them, që e tha edhe Nora që është e përfshirë në këtë iniciativë qysh prej fillimit dhe do të thotë si ide që ka dal kjo. Do të thotë kjo iniciativë mbahet edhe në Serbi, ashtu sikur në Kosovë në vende të ndryshme duke ia nisur prej konsultimeve lokale e deri te ato në nivelin rajonal. Dhe, habiteni edhe ju, e sidomos të rinjtë sa janë konstruktiv në këtë çështje dhe ka edhe prej atyre njerëz, nuk është vetëm një Natasha ose vetëm një Sonja Biserko, po ka edhe njerëz tjerë që nuk donë me bartë në shpinë barrën e asaj çka kanë bërë paraardhësit e tyre.

Ne kem edhe filma, kemi edhe transkriptet po kemi edhe ueb-faqet që janë dokumente që janë të shkruara dhe ato kur doni mund të hyni aty dhe t'i shihni, janë sende të dokumentuara, janë të incizuara, janë të transkribuara e tjera. Nuk është vetëm një Natashë dhe vetëm një Sonjë. Por janë disa njerëz, e që nuk donë ta bartin barrën e fajësisë çka kanë bërë të tjerët, a kuptoni. Normalisht, ne nuk mund të presim që një kriminel t'i pranojë këto. Jo, sepse ai e di ku do t'i del fundi. A kuptoni? Ai e di se në fund do të akuzohet ai. Ai e di që në fund do të dalë emri i tij si kriminel. Mirëpo, njerëzit që nuk kanë pas ndoshta lidhje e që ka pasur të tillë që nuk donë të identifikohen me ta dhe po ashtu ke njerëz të cilëve u vjen marre se çka ka ndodhur.

Keni njerëz, sidomos që është iniciativa e të rinjve, janë disa anëtarë aty të cilët edhe mund t'i shihni nëpër videot të cilët sinjerisht mundohen në njëfarë mënyre të distancohen prej asaj çka ka ndodhur nga paraardhësit e tyre dhe mundohen në çdo mënyrë të organizojnë sa më shumë tubime, e bile-bile bashkëpunojnë edhe me vende tjera, jo vetëm me kosovarë por edhe me boshnjakë, me kroatë e me tjerë. Pra, në njëfarë mënyre të rinjtë distancohen nga ajo çka ka ndodhur dhe të jenë më pas më të shëndetshëm dhe atë me shikua me një sy pak tjetër se çka ka ndodhur. Tash Nora po do me marrë fjalën.

**Nora Ahmetaj:** Mungesa e komunikimit...

**Aqif Ilazi:** Nora e ka dimër pak, po e shoh!

**Nora Ahmetaj:** Duart i kam të ngrira, s'po di që i kam të miat. Më vjen keq, nuk do duhej kështu, e di!



Pra, mungesa e komunikimit krijon edhe barriera, krijon edhe paragjykime, frustrime. Dhe, unë po ju kuptoj, edhe unë jam në atë gjendje me thënë – krejt është politikë, në fund të ditës.

Mirëpo po dua ta tregoj një rast. Tash kur ishim në konsultimet rajonal me ish të burgosurit politikë dhe me llogorashë, në Dubrovnik ishte një pjesëtarë – oficer i lartë i ish-ushtresë jugosllave. Dhe ai tha haptas para të gjithëve, tha: Unë kam gjuajt dhe kam vra. Tha: edhe në komandën time janë bërë shumë krime. Mirëpo, tha: unë po e shoh se ato që i kam bërë në njëfarë mënyre ta laj veten, në njëfarë mënyre të ballafaqohem.

Ai donte të thotë se unë kam qenë instrument i një sistemi dhe propozoi ose thjeshtë donte ta shoh veten pjesë të KOMRA-s – këtij komisioni rajonal dhe thoshte: jam në gjendje me kontribuar me gjithë dijen dhe informatat që i kam për zbardhjen... Sepse ai u ndiente i frustruar prej vetë sistemit, sepse thoshte: edhe unë s'kam dashtë ta bëj atë çka kam bërë por e kam bërë se kam qenë i detyruar.

Vetëm po dua të ilustroj se ka edhe asi individë. Ne i njohim dy persona, por ka edhe individë tjerë. Ka edhe organizata tjera – shoqëri civile në Serbi.

**Aqif Ilazi:** Në Serbi ka, siç është edhe Çedomir Jovanović. Nuk përjashtohet mundësia, a po dini, që ka me pas. Megjithatë janë shumë simbolikë, prandaj po them sepse në këto përmasa nuk ka askund ashtu, sepse ne kemi dëshmitarë dhe po thuaj se një vit kemi qenë 2 serbë 1 shqiptarë në dhomë dhe e dimë çfarë opinionesh kanë ata për ne. Dhe tash mos të themi se kanë qenë njerëz të institucioneve, kush e di, të margjinave të pushtetit ose diçka të ngjashëm. Por me gjithat ka ekzistuar edhe te popullata një bindje e tillë se ne jemi “njerëz me bishta”, se jemi “njerëz të malit” e kushedi çka.

**Bujar Ukimeraj:** Nora, po dua nga ju njëfarë sugjerimi: Ma përkujton filmin e Jezus Krishtit e ata e gozhdofshin me baskia e thoshte – fali zot këta se nuk dinë çka bëjnë. Hë! Hë! Si duket ne do të bëjmë gjithmonë “fali zot këta” e ata thonë “daj bozhe da stigne josh vishe”. Ata e përdorin këtë gjuhën.

**Fehrat Dervish:** Besarta!

**Besarta Vasija:** Po, urdhëroni zotëri Fehrat!

**Fehrat Dervish:** ... Edhe diçka, është për ardhmërinë. A do të munden fëmijët në Serbi të lexojnë në librat shkollore se gjyshët e babët e tyre kanë bërë krime në Kosovë, e Bosnjë. Në qoftë se fëmijët mund të lexojnë dhe nëse do të shkruajnë ato libra shkollore këto gjëra, atëherë do të jetë kërkim-falja më e mirë ajo.

**Besarta Vasij:** Faleminderit, zotëri! Po, urdhëro, zotëri Aqif!

**Aqif Ilazi:** Mos të dukem tendencioz, shumë politik! Po, megjithatë debat është, është e drejtë, jemi kah fundi veç. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do me thënë është heq lufta e fundit, historia e popullit shqiptar nëpër libra ndikon Bashkësia Evropiane. Do të thotë, ne gjithqysh ka mundësi të na i heqin fëmijëve tanë për të mësuar për këto çështje. E atyre, kush e di çka?

**Bujar Ukimeraj:** Unë e përkrah kolegun. Ata jo që do të na shajnë, por do të na lëvdojnë. Do t'i lëvdojnë gjyshërit e vetë dhe do të thonë: mi smo ubili koliko smo hteli u Kosovo.

**Besarta Vasija:** Prandaj ne nuk po domi me lejuar të ndodhë kjo. Prandaj, është kjo iniciativë ku nuk po domi nesër a pasnesër me u pa kriminelët si hero e viktimat me u pa si kriminelë.

**Fehrat Dervish:** Për këtë nuk mjafton edhe ajo kërkesa e faljes nga Kuvendi i Serbisë, por këto gjëra të kërkesë-faljes dhe këto gjëra janë më të mirat.

**Besarta Vasija:** Urdhëro, zotëri Bujar!

**Bujar Ukimeraj:** Besarta! Besoj se është koha ta përfundojmë, por gjithsesi këto i bëjmë sepse ka çka me u bë, ka çka të flasim, kemi çka të tregojmë sa që edhe fletë Kosovën e mbulojnë me histori dhe ndodhi që kanë ndodhur. Por, një është se mos të frikësohemi prej kësaj. Ne i bëjmë këto llafe, por ta dini se e keni përkrahjen prej nesh, prej shtresës, prej meshkujve prej opingës se opingë ne jemi, jemi poshtë. Ata lartë e di që jo se i kanë do befncione më të meçme, larg problemeve politike se i ulin gradat e veta, por ishalla ne si shoqëri civile dhe që thash opinga në kuptimin më të ulët si klasë, që nuk duhet të quhet klasë por ashtu po shkon dhe e qesim në skaj se përndryshe është bukur problem.

**Besarta Vasija:** Faleminderit zotëri Bujar! Pra, nëse nuk ka dikush tjetër të shtojë, unë do t'i përmend edhe dy çështje. Urdhëroni, zotëri!

**Azem Pulaj:** Agim Zogiani, a është në këtë shoqatë?

**Besarta Vasija:** Me Agim Zogianin...

**Azem Pulaj:** Po veç le ta merr një vërejtje, shkurtoje gjuhën: termin – krime të luftës, të dëshmorëve, thuaj të mos ketë, sepse Prizrenin nuk e sheh më.

**Besarta Vasija:** Nuk e dimë, se Agimi ende është...

**Azem Pulaj:** Po, po! Bile është i implikuar me rastin e Kukësit. Dhe është personi i cili do të zbulojë rastin. Edhe kjo është rrezik...

**Besarta Vasija:** Unë mendoj se për këto, duhet drejtuar drejt atyre, ai nuk është pjesë e Koalicionit.

**Azem Pulaj:** Po, po. Agimi, nëse është në këtë shoqatë...?

**Besarta Vasija:** Jo, Agimi nuk është pjesë e Koalicionit dhe mendoj se këto duhet sqaruar.

**Azem Pulaj:** OK. Thuaj se gjuha shkurtohet...

**Besarta Vasija:** Unë vetëm për dy çështje teknike. Ata të cilët kanë udhëtuar prej jashtë Prizrenit, do të thotë shpenzimet i kompensojmë këtu, pasi të përfundojë, me kolegen atje. Dhe, një tjetër. Ata të cilët mendojnë se e mbështesin këtë iniciativë, i keni deklaratat nëpër foldera, në të cilët mund të nënshkruani, do të thotë ata të cilët e përkrahin dhe ata që nuk e përkrahin nuk duhet të nënshkruhen. Sikur që me kolegun e patëm muhabetin rreth kësaj!

**Besarta Vasija:** Dhe, vetëm të ju tregoj. Keni mundësinë të nënshkruani në emrin tuaj personal dhe po ashtu keni mundësi të nënshkruani në emrin e shoqatës ose organizatës nëse jeni të autorizuar ose nëse jeni vetë kryetarë.

Pra lartë nënshkruani emrin tuaj dhe poshtë nëse është në emër të shoqatës, nënshkruhet emri i shoqatës apo organizatës. Nëse jo atëherë edhe poshtë nënshkruani individualisht. Dhe, kur të nënshkruani, na i dorëzoni ne individualisht. Është deklarata për bashkëngjitje, ku shkruan. E keni brenda në follder.

Nëse nuk keni diçka tjetër, ju falënderojmë shumë për pjesëmarrje. Ishte jashtëzakonisht një takim i mirë në të cilin patëm edhe rekomandime shumë të mira. Nëse do diçka Nora apo dikush tjetër, le të urdhërojë. Faleminderit!

**Nora Ahmetaj:** Unë ju falënderoj, sinqerisht. Dhe, nëse ju kam provokuar me ndonjë pyetje, kërkoj falje sepse kjo ka qenë qëllimi dhe natyra pak sa të nxjerrim nga ju ide po edhe përgjigje që nganjëherë edhe është vështirë me i dhënë. Besoj se do të bashkëpunojmë më tej dhe besoj se do të shihemi edhe në konsultime tjera lokale e ndoshta edhe rajonale. Shihemi ndoshta në Prizren, në Prishtinë në ndonjë konsultim tjetër. Ju falënderoj për mundin tuaj, për kohën. Nëse keni diçka, mund ta shtroni?

**Nazim Bahtiri:** Edhe një herë edhe unë kisha pas dëshirë të ju falënderoj shumë për pjesëmarrje. Besoj se aktiviteti juaj për KOMRA-n nuk do të mbarojë me kaq por do të vazhdojë edhe më tutje me pjesëmarrjen tuaj aktive në këtë proces. Faleminderit shumë!

**Isuf Halimi:** Edhe unë, falënderoj shumë! Në ndërkohë, nëse ju nevojiten më shumë informata mund të na kontaktoni këtu ne, në Prizren. Falënderoj pra edhe një herë për pjesëmarrjen.